

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit Bachelor në: "Financë - Kontabilitet"**


**Ofruar nga Kolegji Universitar "LOGOS"**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Prof. Dr. Ingrid SHULI**



**Prof. Dr. Raimonda DUKA**



**Shtator / 2019**

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bsc në: Financë-Kontabilitet**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "LOGOS"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 1, datë 06.01.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 282, datë 04.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Financë-Kontabilitet"
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimit
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	-
16	Numri i studentëve në këtë program studimi	2016 – 2017 12 studentë 2017 – 2018 9 studentë 2018 – 2019 7 studentë

**Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet**

Kolegji universitar “LOGOS” ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2009, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 1055, datë 29.07.2009 “Për licensimin e Shkollës së Lartë Private “LOGOS”. (Aneks 1.1) Sipas këtij vendimi SHLP “LOGOS”, organizohet në dy fakultete: Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Fakultetin Ekonomik.

Programi i studimit Bsc në Financë Kontabilitet është hapur në vitin 2011, në bazë të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 1, datë 01.06.2011. (Aneks 1.3). Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Ekonomik, është i organizuar me kohë të plotë, në tre vite akademike dhe 180 ECTS. Sipas urdhërit të Ministrit në mbarim të programit të studimit lëshohet diploma “Bachelor”.

Programi i studimit Bsc në Financë Kontabilitet është akredituar për herë të parë në vitin 2012 me Urdhërin Nr. 282, datë 04.07.2012 “Për akreditimin institucional dhe të disa programeve të studimit të Shkollës së Lartë Private “LOGOS”. (Aneks 1.5) Akreditimi është mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, Nr. 338, datë 08.06.2012. Në këtë vendim jepet vlerësimi përfundimtar dhe rekomandimet për këtë program studimi

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

#### **Përbërja e GVJ:**

**Prof. Dr. Ingrid Shuli**

**Prof. Dr. Raimonda Duka**

Gjatë gjithë procedurës, ekspertet e jashtme të vlerësimit janë asistuar nga specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Kolegji Universitar “Logos” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 59/18 Prot, datë 26.07.2019. Kolegji Universitar “Logos” përcjell pranë ASCAL më datë 02.08.2019, nëpërmjet shkresës me Nr. 144/1 Prot, datë 01.08.2019 përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

### **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË**

#### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

Këshilli i Akreditimit në vendimin e tij Nr. 338, datë 08.06.2012 ka konstatuar që programi i studimit i përmbush objektivat formues, por ka edhe disa mangësi në realizimin tërësor dhe me cilësi të procesit të formimit të studentëve dhe pajisjes së tyre me dijet dhe shprehitë e nevojshme. Rekomandimet e KA për programin e studimit janë:

- a) Të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe të krijohen strukturat përkatëse universitare si departamentet, etj;

- b) Të punohet për hartimin e një metodologjie të shkruar për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit;
- c) Të punohet më shumë për përdorimin e metodave të tërthorta të vlerësimit për tërheqjen e organizuar të vlerësimit të programeve nga vet studentët;
- d) Të rritet kapaciteti fizik i auditorëve dhe i shërbimeve ndihmëse;
- e) Të plotësohen regjistrat;
- f) Të punohet për rritjen e vizibilitetit të Institucionit në tregun përkatës, për të rritur mundësitë për tërheqjen e studentëve më cilësorë dhe për krijimin e mundësisë për rivendosjen e kritereve përzgjedhëse;

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm dhe vizitës në IAL u konstatua që rritja e numrit të pedagogëve me kohë të plotë është realizuar në vitin akademik 2014-2015. Në periudhën 2014-2017 Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka patur gjithmonë 7 anëtarë, ndërsa personeli me tituj dhe grada për 3 vite akademike ka qënë 3, dhe vetëm në vitin akademik 2015-2016 kanë qënë vetëm 2 personel me tituj dhe grada. Në vitet akademike 2012-2013 dhe 2013-2014 staf me kohë të plotë kanë qënë respektivisht 3 dhe 2 personel. Kolegji Universitar "LOGOS" ka krijuar strukturat (departamente/qendër) të cilat kanë funksionuar që nga viti 2014 (Departamenti Financë-Kontabilitet, Departamenti Menaxhim-Turizëm, Qendra e Kërkimit Shkencor). Për vitet akademike 2015-2016, 2016-2017 dhe 2017-2018 Fakulteti Ekonomik ka 3 Departamente, secili me 7 antarë nga të cilët 2-3 me tituj dhe grada. Meqënëse Këshilli Akreditimit nuk kishte vendosur afate për plotësimin e këtij rekomandimi, mendojmë që rekomandimi është **përbushur plotësisht** për periudhën 2012-2017.

*Por aktualisht për vitin akademik 2018-2019, Departamenti Financë-Kontabilitet ka 6 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët vetëm 2 me tituj dhe grada. (Aneks 95).*

- b) Kolegji Universitar "LOGOS" ka miratuar tri dokumente për sigurimin e cilësisë: Metodologji vlerësimi, Politika për Sigurimin e Cilësisë dhe Rregullore për Sigurimin e Cilësisë. **(Aneks 6.1, Aneks 3.2&3.3 vizita në IAL)** Në opinionin tonë, të tri dokumentet përcaktojnë të gjitha politikat, metodologjinë dhe instrumentat për vlerësimin e programeve të studimit. Politika për Sigurimin e Cilësisë dhe Rregullore për Sigurimin e Cilësisë janë hartuar mbështetur në praktikat më të mira. **Ky rekomandim është përbushur plotësisht.**
- c) Mbështetur në RVB, dokumentacionin e dorëzuar në ASCAL dhe vizitën në institucion **(Aneks 6.2, 6.5, Aneks 3.1 vizita IAL)** u konstatua që Kolegji Universitar "LOGOS" ka miratuar dhe përdorur metoda të tërthorta për të tërhequr mendimin e studentëve për vlerësimin e programeve të studimit. Tërheqja e mendimit realizohet në baza semestrale, përmes pyetësorëve dhe të dhënat e mbledhura përpunohen dhe bëhen të njohura nga IAL. **Ky rekomandim është përbushur plotësisht.**
- d) Mbështetur në RVB, dokumentacionin e dorëzuar në ASCAL dhe vizitën në institucion u konstatua që Kolegji Universitar "LOGOS" ka zgjeruar kapacitetet fizike të auditorëve dhe shërbimeve mbështetëse. **(Aneksi 13)** Sipërfaqet në dispozicion të realizimit të veprimtarisë mësimore dhe veprimtarive mbështetëse janë 4590 m<sup>2</sup> ose 69.9%, më të mëdha se në akreditimin e parë. **Ky rekomandim është përbushur plotësisht.**
- e) Mbështetur në RVB, dokumentacionin e dorëzuar në ASCAL dhe vizitën në institucion u konstatua që Kolegji Universitar "LOGOS" mban dhe plotëson sipas legjislacionit në fuqi të

gjitha regjistrat si: regjistri i të dhënave personale të studentëve, regjistri i notave të studentëve, regjistri i diplomave dhe regjistri i grupit mësimor. Regjistrat e studentëve janë plotësuar për çdo vit akademik dhe përmbajnë të gjitha elementët si: moduli, pedagogu, temat që zhvillohen, emrat e studentëve, datat e zhvillimit të mësimit, mungesat dhe kolona e vrejtimeve dhe sugjerimeve. (Aneks 7.1, 7.2, 7.3 dhe 7.4) **Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

- f) Kolegji Universitar "LOGOS" ka punuar që të rritë vizibilitetin e institucionit në tregun arsimor. Shpërndarja e informacionit realizohet duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi "Për të Drejtën e Informimit". Mjetet kryesore të përdorura janë faqja e internetit, broshurat e ndryshme, media e shkruar dhe elektronike. Megjithatë, duhet theksuar që strategjia e ndjekur deri tani nuk ka dhënë efektet e dëshiruara. Numri i studentëve dhe nota mesatare në hyrje mbetet e ulët. Ka patur një përmirësim në vitet akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, por në vitin akademik 2017-2018 numri i studentëve dhe mesatarja në hyrje janë ulur. **Ky rekomandim është përmbushur kryesisht.**



# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë-Kontabilitet synon krijimin, zhvillimin, përcjelljen dhe mbrojtjen e njohurive bazë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, me synim formimin e specialistëve të lartë në fushën e Financë-Kontabilitetit. Sipas RVB dhe dokumentave strategjik synimi i programit është në përputhje me prioritetet e vendit, për të kontribuar në të ardhmen, në zhvillimin ekonomik, social-kulturor, në nivel kombëtar, rajonal e me gjerë.

**(Ref RVB, fq. 3, Aneks 3.6 ; Aneksi 3.1; Aneks 3.3.2 fq.2; Aneks 3.8).**

Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor Financë-Kontabilitet, janë:

- Të ngrejë cilësinë e njohurive teorike e shkencore të studentit në këtë program studimi;
- Të përgatisë specialistë finance e kontabiliteti për kompanitë e biznesit; për strukturat e sistemit bankar e financiar, për deget e tatim taksave, të sistemit doganor; për auditim e kontroll të brendshëm, për tregjet e bursat, për shoqëritë e sigurimit e të pensioneve,
- Të përgatisë studentet për studime të thelluara të fushës.

Bazuar në RVB, dokumentacionin e dorëzuar në ASCAL dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton që KU Logos e ka mbështetur aktivitetin e tij në një Plan Strategjik për periudhën 2012-2017. Në këtë plan janë përcaktuar prioritet dhe synimet kryesore në fushat e mëposhtme: sigurimi i cilësisë bazuar në standardet evropiane, forcimi i nivelit të cilësisë së mësimdhënies, politikat e kërkimit shkencor, rikonceptimi i strukturës organizative të institucionit, forcimi i bashkëpunimit me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm, përmirësimi i shërbimeve ndaj studentëve, forcimi i bashkëpunimit me partnerët e tregut të punës, krijimi i imazhit të ri të institucionit, etj. **(Aneks 3.6)** KU Logos ka miratuar gjithashtu planin strategjik të zhvillimit për periudhën 2018-2024. Misioni i identifikuar për këtë periudhë është t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, hulumtimit, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global, ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës. Strategjia ka një plan veprimi, në të cilën janë përcaktuar objektivat, masat konkrete dhe rezultatet e pritshme. **(Aneks 92)**

Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka hartuar gjithashtu një strategji të zhvillimit afatshkurtër dhe afatmesëm për periudhën 2017-2021, në të cilën janë përcaktuar objektivat afatshkurtëra dhe afatmesme në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimit shkencor, vlerësimit të stafit, rekrutimit të studentëve, etj. **(Aneks 3.7)**

Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Financë-Kontabilitet, i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit realizohet me 180 kredite, kohëzgjatja normale e tij është 3 vite akademike dhe është me kohë të plotë. Programi ofrohet në gjuhën shqipe. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe departamenti i Financë-Kontabilitetit është përgjegjës për mbarëvajtjen e tij.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>PS synon krijimin, zhvillimin, përcjelljen dhe mbrojtjen e njohurive bazë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, me synim formimin e specialistëve të lartë në fushën e Financës e të Kontabilitetit PS është hartuar në përputhje me misionin e institucionit për t'iu dhënë studentëve njohuri bazë, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore. <b>(Aneks 3.1.2 fq.2; 3.6, fq.2)</b></p> <p>Objektivat e PS janë të përcaktuara qartë dhe janë përfshirë në dokumentat dhe aktet kryesore të institucionet si: strategjia e zhvillimit të departamentit, statuti dhe rregullorja e programit të studimit <b>(Aneks 3.3.2, fq.2; Aneks 3.7)</b></p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që KU Logos ka përcaktuar qartë në rregulloren e PS dijet, aftësitë dhe kompetencat që duhet të fitojnë studentët në përfundim të PS. <b>(Aneks 3.5.2).</b></p> <p>Hartimi i PS është mbështetur kryesisht në partneritetin e departamentit me komunitetin e biznesit të institucioneve bankare dhe financiare. Me vendim rektorati është ngritur Bordi i Tregut të Punës me qëllim konsultimin e programeve të studimit dhe përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. <b>(Aneks 1.15, RVB)</b></p> <p>PS është hartuar duke mbajtur parasysh kryesisht nevojat e tregut financiar dhe bankar.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh në realizimin e misionit dhe</p>	<p>Referuar dy planeve strategjike të KU Logos 2012-2017 dhe 2018-2024, RVB-së dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi që hartimi dhe përditësimi i PS mbështetet në stategjinë për zhvillimin e institucionit.</p> <p><b>(Aneks 92, Aneks 3.6, Aneks 3.3.2).</b></p> <p>Sipas RVB, PS synon pajisjen e studentëve me njohuri, aftësi dhe eksperiencia që i ndihmojnë ata për të hyrë në tregun e punës në sektorin financiar dhe bankar. <b>(RVB)</b></p>

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

qëllimit të institucionit;	PS synon që përmes njohurive specifike që ofron të përgatisë specialistë finance e kontabiliteti për kompanitë e biznesit; për strukturat e sistemit bankar e financiar, për degët e tatim taksave, të sistemit doganor; për auditim e kontroll të brendshëm, për tregjet e bursat, për shoqëritë e sigurimit e të pensioneve. (RVB)
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>PS synon plotësimin e nevojave të tregut të punës me specialistë finance dhe kontabiliteti. Ky synim përputhet me objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar për zhvillimin e sektorit bankar dhe financiar.</p> <p>KU Logos ka kryer një studim tregu për programin MP në Financë-Kontabilitet (<b>Aneks 3.10</b>), <i>por nuk ka studim tregu për programin bachelor.</i></p>
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Mbështetur në informacionin e marrë përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion konstatoam që objektivat e PS nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Synimi i PS është formimi i specialistëve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. (<b>Aneks 3.5.2, fq.2</b>)</p> <p>Programi i studimit gjithashtu siguron ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p>Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ PS bachelor në Financë-Kontabilitet është në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL, si dhe me strategjinë për zhvillim të institucionit. Hartimi i PS mbështetet kryesisht në partneritetin e departamentit me komunitetin e biznesit të institucioneve bankare dhe financiare, dhe nuk ka një vlerësim të mirëfilltë tregu për këtë PS</li> <li>✓ PS synon plotësimin e nevojave të tregut të punës për specialistë në fushën e financë-</li> </ul>	



kontabilitetit, duke ruajtur vlerat kulturore dhe interesat kombëtare.

Rekomandim:

KU "Logos" të bëjë një studim tregu sipas kërkesave të Standardit II.1, Kriterit 2.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkimore

*Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit*

Struktura organizative e KU Logos është përcaktuar në Statutin e Institucionit dhe respekton kërkesat e Ligjit nr. 80/2015. Statuti, rregullore e fakultetit, rregullore e departamentit dhe rregullore e programit të studimit janë miratuar në vitin 2017, në përputhje me Ligjit nr. 80/2015 dhe bazën ligjore në fuqi. KU Logos përbëhet nga Njësitë Kryesore (Fakultetet) dhe Njësitë Bazë (Departamentet). KU Logos përbëhet nga 2 Njësi kryesore: (**Aneks 3.1.1, Aneks 3.1.2, Kreu II, Organigrama**)

#### 1. Fakulteti Ekonomik;

#### 2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara;

Organet drejtuese të Njësisë kryesore janë: Dekanati, Asambleja e Personelit Akademik dhe Komisionet e Përhershme. Sipas rregullores së fakultetit detyrat kryesore të dekanatit janë: harton planin strategjik të zhvillimit të Njësisë Kryesore, koordinon veprimtarinë e njësisive bazë në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre, orienton rishikimin e programeve të studimit, hapjen e programeve të reja, etj. (**Aneks 3.3.2**) Ndërsa autoritetet drejtuese janë: Dekani, Administratori i Fakultetit dhe Drejtuesit e Departamenteve. Disa nga funksionet kryesore të dekanit të përcaktuara në rregullore janë: mbikëqyrja e mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësitë bazë, organizimi i regjistrimit të studentëve në programet e studimit, miratimi i komisioneve të provimeve të formimit dhe mbrojtjes së diplomave, etj.

Drejtuesi i njësisë bazë është autoriteti drejtues akademik, detyrat e të cilit janë përcaktuar në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e departamentit. Ndër detyrat kryesore të përcaktuara në rregullore janë: merr masa për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe kërkimor, kërkon rishikime dhe përmirësime të programeve të studimit, përcakton tematikën e punës shkencore, organizon mbështetjen dhe këshillimin e studentëve për programet e studimit të ciklit të dytë, kontrollon cilësinë e mësimdhënies, etj. (**Aneks 3.3.2, Aneks 3.4**)

Mësimdhënia dhe veprimtaria shkencore e njësisë asistohet nga stafi ndihmës akademik dhe stafi administrativ. Fakulteti mbështet në veprimtarinë e tij nga disa struktura të cilat funksionojnë në nivel institucioni si: Sekretaria Mësimore, Biblioteka, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkiva, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, pranimeve dhe këshillimit për karrierë, Zyra e financës dhe shërbimeve, etj. Detyrat dhe funksionet e tyre janë përcaktuar në statut. (**Aneks 3.1.2**)

Për vitin akademik 2017-2018 Fakulteti ka në përbërjen e tij 26 personel nga të cilët 21 personel akademik efektiv (PAE), 3 personel akademik me kontratë (PAK) dhe 2 personel administrativ.

Numri i personelit akademik efektiv ka qënë i njëjtë për 3 vitet e fundit akademike dhe i shpërndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet njësive bazë (7 antarët për secilën njësi). Ndërsa numri i personelit akademik me kontratë ka patur ndryshime të vogla.

Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik efektiv përbëhet nga 1 Profesor i Asociuar, 9 Dr/Phd dhe 11 Msc. Ndërsa nga personeli akademik me kontratë 2 kanë gradën Dr/Phd dhe 1 është Prof.As. Kërkesat e ligjit për përbërjen e personelit akademik në nivel njësie bazë janë respektuar që nga viti akademik 2014-2015. (**Aneks Tabela 2**)

Për vitin akademik 2018-2019 Fakulteti ka në përbërjen e tij 26 personel akademik nga të cilët 18 personel akademik efektiv (PAE), 8 personel akademik me kontratë (PAK). Numri i personelit akademik efektiv është ulur me 14.3% krahasuar me vitin akademik 2017-2018. Ndërsa numri i personelit akademik me kontratë është rritur me rreth 2.7 herë.

Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik efektiv përbëhet nga 1 (një) Profesor, 2 (dy) Profesor të Asociuar, 6 (gjashtë) Dr/Phd dhe 9 (nëntë) Msc. Ndërsa nga personeli akademik me kontratë 3 (tre) kanë gradën Dr/Phd, 2 (dy) Prof.As dhe 3 (tre) Prof.Dr. Kërkesat e ligjit për përbërjen e personelit akademik në nivel njësie bazë janë respektuar që nga viti akademik 2014-2015 deri në vitin akademik 2017-2018. (**Aneks 84**)

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Struktura akademike e Fakultetit**

Fakulteti Ekonomik përbëhet nga 3 Njësi bazë: Departamenti i Financë-Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit të Turizmit, Departamenti i Menaxhimit të Biznesit. (**Aneks 3.1.1, Aneks 3.1.2, Kreu II, Organigrama**). Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit, i cili ofron programe studimi që synojnë të formojnë specialistë të lartë dhe të përgatisë profesionistë në fushën e Financë Kontabilitetit, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. (**Aneks 3.4**) Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë ka miratuar gjithashtu që në vitin 2016 koordinatoret e programeve të studimit. (**Aneks 1.8**)

KU "Logos" ka një numer relativisht të vogël studentësh, dhe në fillimet e tij procesi mësimor është realizuar kryesisht nga personel akademik me kontratë, me tituj dhe grada shkencore. Pas akreditimit të parë, për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit me vendimin Nr. 338, datë 27.06.2012, dhe në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Fakulteti i Ekonomisë ka krijuar strukturat përkatëse universitare, duke punësuar personel akademik efektiv. Strukturat akademike janë krijuar në vitin 2014.

##### **Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës**

Departamenti përgjegjës për programin e studimit është Departamenti i Financë-Kontabilitetit. Sipas RVB dhe vizitës në IAL realizimi i planit mësimor mundësohet në bashkëpunim me dy departamentet e tjera të Fakultetit Ekonomik.

Për vitin akademik **2018-2019** stafi i Fakultetit Ekonomik përbëhet: si më poshtë:)

**Departamenti i Financë-Kontabilitetit** përbëhet nga 6 (gjashtë) personel akademik efektiv (PAE), 3 (tre) personel akademik me kontratë (PAK). Njësia bazë, Departamenti drejtohet në të gjithë veprimtarinë e tij nga përgjegjësi i departamentit, që mban titullin Prof. As. Stafin akademik

efektiv i departamentit ka:1(një) anëtar që mban titullin Prof.Asociuar, 1(një) anëtar që mban gradën Doktor dhe 4 (katër) anëtar me kualifikimin Msc. (**Aneks 84**)

**Departamenti Menaxhim Biznesi** përbëhet nga 6 (gjashtë) personel akademik efektiv(PAE), 2 (dy). personel akademik me kontratë (PAK). Njësia bazë, Departamenti drejtohet në të gjithë veprimtarinë e tij nga përgjegjësi i departamentit, që mban titullin Dr. Stafit akademik efektiv i departamentit ka: 1(një) anëtar që mban titullin Prof.Asociuar, 3(tre) antarë që mbajnë gradën Doktor dhe 2 (dy) anëtar me kualifikimin Msc. (**Aneks 84**)

**Departamenti i Menaxhim Turizmit** përbëhet nga 6 (gjashtë) personel akademik efektiv (PAE), 3 (tre) personel akademik me kontratë (PAK). Njësia bazë, Departamenti drejtohet në të gjithë veprimtarinë e tij nga përgjegjësi i departamentit, që mban titullin Prof. Stafit akademik efektiv i departamentit ka 1(një) antar që mban titullin Prof.Dr, 2 (dy) anëtarë me gradën Dr/PhD dhe 3 (tre) anëtar me kualifikimin Msc. (**Aneks 84**).

*Me anë të shkresës me Nr. 48. Prot, datë 10.01.2019, Kolegji Universitar "LOGOS", i është drejtuar MASR ,për të miratuar ushtrimin e të drejtës që i jep Ligji 80/2015, për të mos plotësuar kushtet e pikës 4 të nenit 25,mbi numrin e personelit akademik të departamentit. Në urdhërin e MASR Nr. 29, datë 21.01.2019 urdhërohet ngritja e grupit të punës për vlerësimin e kërkesës së bërë nga Kolegji Univeritar "LOGOS".(Aneksi 97)*

Dekanati ka emëruar gjithashtu në Prill 2016 koorinatorin e programit të studimit bachelor. (**Aneksi 1.8**).

Nga vizita në KU "Logos" u konstatua se në vitin akademik 2018-2019 ka patur lëvizje në stafin akademik në të tre Njësitet Bazë, duke ulur numrin e PAE.

Për periudhën midis dy akreditimeve raportet PAE/PAK të departamentit të Financë Kontabilitetit kanë qënë si më poshtë: (**sipas RVB**)

Për vitin akademik **2018-2019**, (**6 / 3**), nga këta me grada/tituj **2 / 3**;

Për vitin akademik **2017-2018**, (**7 / 1**), nga këta me grada/tituj **3 / 1**;

Për vitin akademik **2016-2017**, (**7 / 1**) nga këta me grada /tituj **3 / 1**;

Për vitin akademik **2015-2016**, (**7 / 1**) nga këta me grada /tituj **2 / 1**;

Për vitin akademik **2014-2015**, (**7 / 2**) nga këta me grada /tituj **3 / 2**;

Për vitin akademik **2013-2014**, (**2 / 12**) nga këta me grada /tituj **1 / 6**;

Për vitin akademik **2012-2013**, (**3 / 10**) nga këta me grada /tituj **1 / 5**;

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Gjatë vizitës në institucion nuk u kërkuar dokumentacion shtesë.

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA),*

*raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.*

Stafi akademik i programit të studimit Bsc Financë-Kontabilitet përbëhet nga 19 pedagogë për vitin akademik 2017-2018, ndër të cilët 18 (tetëmbëdhjetë) janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 1 (një) Personel Akademik me Kontratë (PAK). Numri i personelit akademik me tituj dhe grada është 7 (shtatë) ose 36.8% e personelit të përgjithshëm. Nga këta 6 (gjashtë) ose 85.7% janë Personel Akademik Efektiv (PAE). **(RVB, tabela 4, fq. 25)**

Stafi akademik i programit të studimit Bsc Financë-Kontabilitet përbëhet nga 18 pedagogë për vitin akademik 2018-2019, ndër të cilët 14 (katërmëdhjetë) janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 4 (katër) Personel Akademik me Kontratë (PAK). Numri i personelit akademik me tituj dhe grada është 7 (shtatë) ose 38.8% e personelit të përgjithshëm. Nga këta 3 (tre) ose 16.7% janë Personel Akademik Efektiv (PAE). **(Aneks 82)**

Zyra e burimeve njerëzore në KU "Logos" dhe Departamenti Financë-Kontabilitet janë përgjegjës për rekrutimin e stafit akademik, që angazhohet në procesin e mësimdhënies. Kriteret e punësimit përcaktohen nga Njësia Bazë dhe konkursi drejtohet nga një komision *ad hoc*, që në shumicë përbëhet nga antarë të Njesisë Bazë. Këto struktura ndjekin të gjitha procedurat e rekrutimit sipas akteve në fuqi. Disa nga kriteret e përzgjedhjes së kandidatit janë: titulli/grada shkencore, përvoja akademike, kualifikimi jashtë vendit në universitete perëndimore dhe etika e komunikimit. KU "Logos" i ka dhënë prioritet rekrutimit të stafit që ka kryer studime në universitete perëndimore. Marrëdhëniet e punësimit janë të rregulluara sipas akteve ligjore në fuqi, statutit dhe rregullores së KU "Logos". **(Ref RVB, fq 24, Aneks 3.1.2, kreu IV , Aneks 3.2.2, kreu VI, Aneks 1.13, Aneksi 5.3, Aneks 5.1).**

Raporti PAE/PAK për vitin akademik 2018-2019 në nivelin e Njesisë kryesore (Fakultetit) është 18/8. Ndërsa në nivelin e Njesisë Bazë (Departamentit) treguesit janë: PAE/PAK 6/3. **(Aneksi 84)**

Shpërndarja e ngarkesës mësimore realizohet mbështetur në aktet nënligjore të MASR. Deri në vitin akademik 2017-2018 është bazuar në Udhezimin nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë". Gjithashtu, në ndarjen e ngarkesës është mbajtur në konsideratë dhe Rregullore e Përgjithshme e KU Logos **(Aneksi 3.2.2).**

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,**

Të dhënat për Personelin Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelin Akademik me Kontratë (PAK), i përfshirë në programin e studimit Financë-Kontabilitet paraqiten në tabelën 4 (shin në Aneks). Gjatë vizitës në institucion u konfirmua që të dhënat e paraqitura në këtë tabelë përputhen me gjendjen në institucion.

Nga analiza e të dhënave për personelin akademik të përfshirë në mësimdhënien e programit të studimit për periudhën 2012-2019, rezulton si më poshtë: **(Tabela 4, Aneks 95)**

- ✓ Për vitin akademik 2018-2019, personeli akademik përbëhet nga 18 pedagogë, nga të cilët 14 PAE dhe 4 PAK (ose 77%/23%).
- ✓ Për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik përbëhet nga 19 pedagogë, nga të cilët 18 PAE dhe 1 PAK (ose 94.7%/5.3%).
- ✓ Për vitin akademik 2016-2017, personeli akademik përbëhet nga 19 pedagogë, cilët janë të gjithë PAE.(100%)
- ✓ Për vitin akademik 2015-2016, personeli akademik përbëhet nga 21 pedagogë, nga të cilët 17 PAE dhe 4 PAK (ose 81.0%/19.0%).
- ✓ Për vitin akademik 2014-2015, personeli akademik përbëhet nga 22 pedagogë, nga të cilët 17 PAE dhe 5 PAK (ose 77.3%/22.7%).
- ✓ Për vitin akademik 2013-2014, personeli akademik përbëhet nga 27 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 23 PAK (ose 14.8%/82.3%).
- ✓ Për vitin akademik 2012-2013, personeli akademik përbëhet nga 28 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 24 PAK (ose 14.3%/85.7%).

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program për vitin akademik aktual është **18 / 28**, (Studentët i perkasin ciklit të studimit të tre viteve të fundit).

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është **14 / 4**.

Mbështetur në analizën e të dhënave të mësipërme, GVJ konstaton se në pesë vitet e fundit akademike për të cilat akredidohet ky program studimi Personeli Akademik Efektiv ka qënë mbi normën 75.0%. Referuar tabelës 13 që paraqet planin mësimor të lidhur më planin akademik rezulton që për vitet akademike 2012-2013 dhe 2013-2014 vetëm 11.4% e ngarkesës mësimore mbulohej nga PAE, tregues ky që në vitet pasardhëse akademike është përmirësuar shumë. Në dy vitet e fundit akademike (2016-2017 dhe 2017-2018) mësimdhënia mbulohet pothuajse e gjitha nga PAE.

#### **Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

Tabela 5 në aneks paraqet të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre për personelin akademik që është përfshirë në këtë program studimi. Nga të dhënat e tabelave rezultojnë:

- ✓ Viti akademik 2018-2019 7 (shtatë) personel me tituj dhe grada ose 38.9%, nga të cilët 4 (katër) PAK
- ✓ Viti akademik 2017-2018 7 (shtatë) personel me tituj dhe grada ose 36.8%, nga të cilët vetëm 1 (një) PAK.
- ✓ Viti akademik 2016-2017 5 (pesë) personel me tituj dhe grada ose 26.3%.
- ✓ Viti akademik 2015-2016 8 (tetë) personel me tituj dhe grada ose 38.1% , nga të cilët 2 (dy) PAK
- ✓ Viti akademik 2014-2015 11 (njëmbëdhjetë) personel me tituj dhe grada ose 50.0%, nga të cilët 4 (katër) PAK.
- ✓ Viti akademik 2013-2014 14 (katërmëdhjetë) personel me tituj dhe grada ose 51.9%, nga të cilët 12 (dymbëdhjetë) PAK.
- ✓ Viti akademik 2012-2013 13 (tremëdhjetë) personel me tituj dhe grada ose 46.4%, nga të cilët 11 (njëmbëdhjetë) PAK.

Mbështetur në analizën e të dhënave të mësipërme, GVJ konstaton që KU "Logos" krahas rritjes së numrit të PAE është përpjekur që të ruajë raportin midis personelit me tituj dhe grada dhe personelit pa tituj dhe grada.

**Të dhënat sipas gjinisë**

Duke analizuar përbërjen e stafit akademik të Departamentit Financë-Kontabilitet sipas gjinisë, GVJ konstaton që stafi akademik përbëhet kryesisht nga femra për të gjithë periudhën 2012-2018. Përjashtim bën viti akademik 2014-2015, në të cilin raportet gjinore janë të balancuara (57.1% femra dhe 42.9 meshkuj), ndërsa në vitet akademike pasardhëse këto raporte nuk kanë ndryshuar (6 femra dhe 1 mashkull, ose 85.7% femra dhe 14.3% meshkuj).

Gjithashtu personeli akademik efektiv i programit të studimit përbëhet kryesisht nga femra. Për periudhën 2014-2019, që korespondon me rritjen e rekrutimeve për PAE, GVJ konstaton që është rritur shumë % e femrave në PAE nga 52.9% në vitin akademik 2014-2015, në 83.3% në viti akademik 2017-2018.

Për vitin akademik 2018 – 2019 raporti femra/meshkuj për këtë program studimi është 13/5

**Të dhëna sipas moshës së personelit**

Tabela 6. paraqet përbërjen sipas moshës të PAE dhe PAK të programit të studimit. Të dhënat janë vetëm për vitin akademik 2017-2018. Bazuar në këto të dhëna, GVJ konstaton që mungon një shpërndarje e harmonizuar mes grup moshave për PAE. Kështu 62.3% e PAE i përkasin grup moshës 25-35 vjeç, ndërkohë që nuk ka PAE të grup moshës 46-55 vjeç.

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

GVJ mbështetur në RVB dhe dokumentacionin mbështetës të dorëzuar në ASCAL, informacionin e marr gjatë takimeve me personelin në institucion dhe shqyrtimi i praktikave të rekrutimit konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ janë parashikuar në statutin e IAL. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe PAE/PAK rregullohen me kontratën punës, e cila hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në emër të punëdhënësit kontrata firmoset nga Rektori. Në kontratën e punës përshkruhen: pozicioni i pedagogut në departament, ngarkesa mësimore, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit, kohëzgjatja e kontrates etj. Gjatë vizitës në institucion u konstatua që personeli i njihte detyrimet kontraktore dhe se kishte firmosur kontratën e punës me punëdhënësin.

**(Ref RVB, fq 30, Aneks 3.1.2, kreu IV, Aneks 5.3, Aneks 5.4, Aneks 5.5).**

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë**

KU Logos ka rekrutuar personel administrativ për realizimin e programit të studimit në të dy ciklet. Në nivelin e Njesisë Kryesore, ka vetëm 2 (dy) personel administrativ, të cilët i shërbejnë nevojave të tre departamenteve, por që janë të përfshirë në Departamentin e Financë-Kontabilitetit. Stafi administrativ siguron funksionimin e mirë të laboratoreve të informatikës, të mjediseve mësimore dhe atyre ndihmëse, etj. Pjesa tjetër e stafit administrativ i përgjigjet nevojave të të gjitha Njësive kryesore.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

.Trajnime të stafit akademik për projekte ndërkombëtare.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b> <b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Procedurat për rekrutimin e personelit janë të parashikuara në statutin dhe rregulloren e KU "Logos". Hartimi i këtyre procedurave është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH. (<b>Aneks 3.1.2, kreu IV, Aneks 3.3.2, kreu VI</b>)</p> <p>Njësia Bazë luan rolin kryesor në rekrutimin e stafit. Nga takimi me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe shqyrtimi i një procedure për rekrutimin e personelit akademik u konstatua që ishte krijuar komisioni <i>ad hoc</i> me vendim rektori, pjesa më e madhe e antarëve të komisionit ishin personel i Departamentit Financë-Kontabilitet dhe përzgjedhja ishte mbështetur në kriteret të qarta dhe të matshme si: diploma, grada, eksperiencia akademike dhe eksperiencia në fushën e kërkuar. (<b>Aneks 5.3</b>)</p> <p>Mbështetur në të dhënat që IAL ka paraqitur në tabelat respektive në RVB, GVJ konstatoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik <b>2016-2017</b> personeli me kohë të plotë përbën <b>100%</b> të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit(<b>19/0</b>). (<b>Sipas RVB</b>)</li> <li>- Për vitin akademik <b>2017-2018</b> personeli me kohë të plotë përbën <b>94.7%</b> të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit (<b>18 nga 19 gjithsej</b>). Në RVB është deklaruar shifra 71.0%, e cila në opinionin tonë nuk është llogaritur saktë. (<b>Sipas RVB</b>)</li> <li>- Për vitin akademik <b>2018-2019</b> personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën <b>77.7%</b> të personelit akademik të angazhuar për realizimin e PS(<b>14 nga 18 gjithsej</b>). (<b>Aneks 95</b>)</li> </ul> <p>Nga takimi me personelin akademik, NJSBC dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore u konstatua që vlerësimi i personelit akademik realizohet në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi nga studentët përmes pyetësorëve;</li> <li>- Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit;</li> <li>- Vetëvlerësimi;</li> </ul> <p>Procedura e vlerësimit të punës së pedagogëve</p>

	<p>përfshin performancën e pedagogut në auditor, realizimin e ngarkesës mësimore dhe punën kërkimore-shkencore. Procedura e vlerësimit të stafit kryhet në Tetor. ku secili raporton në një sistem elektronik dhe informacioni ballafaqohet me objektivat. Personeli akademik dhe drejtuesit e KU njihen me rezultatet e vlerësimit, të cilat diskutohen dhe përmbledhen në raportet e hartuara nga NJSBC. <b>(Aneks 5.9, Aneksi 5.11 Anekset 6.2-6.5)</b>.</p> <p>Nga takimi me ZBNJ u konstatua që kjo zyrë ka një dosje të aplikimeve, e cila përmban vendimin e komisionit <i>ad hoc</i> për përzgjedhjen e personelit, njoftimet e publikura, si gjithë dokumentacionin për secilin aplikant, ku përfshihen: kërkesa e aplikantit, CV, Diplomat, titujt e fituar etj. Dokumentacioni ruhet vetëm në letër.</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>KU Logos disponon të dhëna të hollësishme për PAE dhe PAK që janë të përfshirë në këtë program studimi. Të dhënat ndodhen në dosjen personale të çdo pedagogu dhe ruhen në ZBNJ. Dosja individuale përmban CV, diploma Bsc, diplome Msc, titujt e fituar etj.</p> <p>KU "Logos" disponon një listë të plotë të PAE dhe PAK për të gjithë periudhën 2012-2019. Në këto lista përfshihet pozicioni në departament, titulli ose grada, institucioni ku punojnë PAK, moduli dhe ngarkesa mësimore. <b>(Aneks Tabela 4 dhe Tabela 13, Aneks 95)</b></p> <p>Lista e personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ nuk përfshihet në këtë raport, pasi ky staf mbështet më shumë sesa një PS.</p> <p>Nga takimi me Drejtuesen e Departamentit dhe personelin e ZBNj , GVJ konstatoi që Departamenti përcjell për çdo semestër në ZBNj vendet vakante dhe harton kriteret për rekrutimin e personelit akademik. Kriteret bazohen në Ligjin nr.80/2015 dhe KU nuk aplikon kriteret të veçanta. Njoftimi për pozicionet e lira, kriteret që duhet të plotësojë aplikanti dhe procedura e rekrutimit shpallen në faqen e KU, në median e shkruar dhe atë elektronike nga ZBNj.</p> <p>Në programin Bsc në Financë-Kontabilitet rreth 76.0% e titullarëve të lëndëve/moduleve kanë diplomën Msc. <i>Kjo përbërje e personelit akademik</i></p>



	<i>nuk përmbush kërkesat e Ligjit nr.80/2015, neni 59, pika 3-4, i cili kërkon që titullarët të jenë të kategorisë profesor/lektor. Situata u konstatua mbështetur në RVB (tabela 13) dhe(Aneks 95).</i>
<b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktur për 12 studentë).</p>	<p>Kurrikula e PS përmban laboratore në modulet informatikë dhe kontabilitet i kompjuterizuar. Gjatë vizitës në institucion dhe në laboratore, GVJ konstatoi që KU ka angazhuar personel ndihmës për realizimin e orëve laboratorike. Gjithashtu një staf administrativ i specializuar për informatikë kujdeset për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe përditësimin e programeve kompjuterike. Pedagogët e Departamentit u shprehën të kënaqur për mbështetjen që merrnin nga personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe ai administrativ për realizimin e kurrikulës. Shpërndarja e burimeve njerëzore midis Njësive Bazë të FE është bërë në përputhje me kërkesat specifike që kanë PS të ofruara nga KU "Logos"dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015. Kualifikimet dhe eksperiencia e PAE dhe PAK të përfshirë në këtë PS mundësojnë përmbushjen e objektivave të PS. Personeli akademik me tituj dhe grada është angazhuar gjithashtu si PAK pasi është larguar nga IAL.</p> <p>Raporti pedagog/studentë për këtë program studimi në vitin akademik 2017/2018 ka qënë 7 pedagog/60 studentë ose 1/8.6. Mbështetur në listën e personelit akademik që angazhohet në programin e studimit GVJ konstatoi që nuk ka asnjë rast që pedagogu të mbuloj më shumë se 3 module. (Ref RVB, fq. 32, Aneks 5.1, Aneks 95).</p> <p>Kurrikula e PS përmban kryerjen e praktikës profesionale në semestrin e VI. Mbështetur në numrin e studentëve të regjistruar në këtë PS për periudhën 2012-2019, GVJ konstatoi që Departamenti Financë-Kontabilitetit ka personel të mjaftueshëm për instruktim, udhëheqje praktikash profesionale, dhe ka një numër më të vogël studentësh për instruktur sesa e parashikon kriteri 3. (Aneksi 7.7).</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjeshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të	KU "Logos" nuk ka hartuar programe specifike për kualifikimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Por në takimin me GVB u informuam që

<p>personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>kualifikimi i vazhdueshëm i personelit është adresuar përmes projekteve në partneritet me universitete brenda dhe jashtë vendit: si Erasmus+ dhe projekti IPA. (Aneks 5.12.2)</p> <p>KU "Logos", disponon një bazë të plotë të dhënash për programin e studimit Bsc Financë-Kontabilitet. KU ka bërë ndryshime në programin e studimit gjatë viteve 2012-2018, të cilat janë miratuar nga MASR. (Aneks 4.1, Aneks 4.2, Aneks 4.3, Aneks 94)</p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

- ✓ Kriteret dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit bazohen në ligjislacionin në fuqi dhe ato janë të hapura dhe transparente. Personeli akademik ka kualifikimin e nevojshëm për këtë program studimi. aktualisht 77.0% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e PS është PAE.
- ✓ KU Logos disponon të dhëna të hollësishme për PAE dhe PAK që janë të përfshirë në këtë program studimi për të gjithë periudhën 2012-2019.
- ✓ KU "Logos" ka angazhuar personel ndihmës-akademik dhe administrativ për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe përditësimin e programeve kompjuterike ku zhvillohen modulet e informatikës dhe kontabilitetit të kompjuterizuar. Shpërndarja e personelit akademik midis Njësive Bazë është në përputhje me kërkesat që ka PS dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015. Kualifikimet dhe eksperiencia e PAE dhe PAK të përfshirë në këtë PS mundësojnë përmbushjen e objektivave të PS. Njësia bazë ka personel të mjaftueshëm për realizimin e praktikave profesionale.
- ✓ KU "Logos" nuk ka programe specifike për kualifikimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik, por ai është angazhuar që përmes projekteve në partneritet me universitete brenda dhe jashtë vendit të sigurojë kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

**Rekomandim:**

- *Të hartohen programe specifike trajnimi për personelin akademik efektiv të kategorisë asistent lector;*

**4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.*

KU "Logos" e zhvillon aktivitetin e tij në një godinë shumëkatëshe në rrugën "Dritan Hoxha". Godina është në pronësi të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe i është dhënë në përdorim

pa afat dhe pa pagesë Fondacionit Logos. Sipërfaqja e shfrytëzueshme e objektit është 4590 m<sup>2</sup>. Godina siguron infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mesimor. Sipas dokumentave të dorëzuara nga KU në ASCAL dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se objekti plotëson të gjitha parametrat e një objekti arsimor. Objekti ka ndriçim mbi 30%, ka sistem të rregullt ngrohje dhe ftohje, ka akustike të mirë, ndodhet larg zonave industriale, apo me ndotje mbi normat e lejuara, ka burime alternative të furnizimit me ujë, dy ashensorë dhe shkallë emergjence, etj. Sipërfaqja në m<sup>2</sup> e shfrytëzueshme për student është 10-12 m<sup>2</sup>.

Në shërbim të studentëve është biblioteka, në të cilën studentët mund të aksesojnë litaraturën në shqip dhe gjuhë të huaj, si dhe tekstet mësimore universitare që përdoren në këtë program studimi. Në bibliotekë ofrohet dhe shërbimi i internetit dhe studentët mund të aksesojnë literaturë online përmes bibliotekës së Universitetit të Pireut. KU ka dhe një palestër të pajisur me vegla sportive, e cila mund të përdoret nga studentët dhe personeli në kohën e lirë.

(Ref RVB fq 34, Aneksi 10.1, Aneksi 10.2), Aneksi 10.3, Aneks 10.4, Aneks 10.5).

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Mjediset për Programin e studimit**

GVJ i është referuar tabelave me të dhënat mbi infrastrukturën në RVB, dokumentacionit të depozituar nga KU "Logos" në ASCAL dhe verifikimit të bërë gjatë vizitës në institucion. Të dhënat mbi infrastrukturën për procesin mësimor dhe stafin janë paraqitur në nivelin e Njësisë Kryesore, ndërsa të dhënat për disa shërbime mbështetëse janë në nivel institucioni.

Fakulteti i Ekonomisë ka në dispozicion të programeve të studimit 4 salla leksionesh, me sipërfaqe 240 m<sup>2</sup> dhe kapacitet 200 vende; 5 salla seminaresh, me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup> dhe kapacitet 125 vende. FE ka gjithashtu në funksion të mësimdhënies, 2 laborator informatike me 30 poste pune, mjedis për fotokopje, për organizimin e aktiviteteve të qeverisë studentore, mjedise shplohëse, etj. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me tavolina, karrike, dërrase dhe pajisje audiovizive në sallat e leksioneve. (Aneks Tabela 7)

#### **Mjediset për stafin**

Fakulteti i Ekonomisë ka në dispozicion të personelit akademik 4 zyra me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, zyrën e Dekanit dhe Zyrën e Departamentit. Në funksion të stafit janë dhe disa zyra të tjera si: zyra për sekretarinë mësimore, zyra e financës, zyra për NJSBC, sallë për mbledhje, etj. Të dhëna të detajuara për këto mjedise gjenden në **tabelen 7.1 në aneks**.

Referuar të dhënave të mësipërme, GVJ vlerëson që KU "Logos" ka vendosur në dispozicion programit të studimit Bsc në Financë-Kontabilitet infrastrukturën e duhur, me kapacitete të mjaftueshme, me kushtet e duhura, të ndricimit, furnizimit me ujë, ngrohjes dhe ftohjes si dhe mbulimit me internet. Gjithashtu në funksion të mësimdhënies janë vendosur dhe pajisje të ndryshme si kompjutera, videoprojektorë, programe kompjuterike si Alfa dhe Financa 5.

#### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Rregullore e bibliotekës.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b> <b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që në bibliotekën e KU Logos ishin në dispozicion të studentëve tekstet mësimore të detyrueshme për PS. <i>Në bibliotekë ka literaturë ndihmëse, por vetëm një pjesë e vogël e saj është në funksion të programit të studimit.</i></p> <p>Numri i kopjeve të literaturës bazë është i vogël, por që mund të përballoj kërkesën e studentëve. Titujt e teksteve mësimore janë të autorëve të njohur shqiptarë ose tekste mësimore të përkthyer.</p> <p>Biblioteka ka akses në librari online, të mundësuar nga Universiteti i Pireut. Ky fond përmban libra dhe revista që i shërbejnë realizimit me sukses të programit të studimit. Por stafi i bibliotekës nuk ka të dhëna sesa këto fonde shfrytëzohen nga studentët e ciklit të parë. Në funksion të mësimdhënies janë dhe dy programe kompjuterike për kontabilitetin (Alfa dhe Financa 5), të cilat përdoren nga studentët në mjediset e laboratorëve.</p> <p>Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë periodike. Në takimin me Drejtuesen e Departamentit u informuam që së fundmi fondi ishte pasuruar me tekste të financë-kontabilitetit. Në pasqyrat financiare është e vështirë të identifikohet buxheti për bibliotekën. Por në pasqyrat e vitit 2017 gjetëm shpenzime për libra në shumën 29,700 lekë.</p> <p><b>(Aneks 9.1)</b></p> <p>Biblioteka funksionon në orare të përshtatshme për studentet dhe pedagoget. Oraret e punës së bibliotekës ishin të afishuara në mjediset e KU.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparataturat dhe</p>	<p>Nga të dhënat e detajuara të RVB, dokumentacioni i dorëzuar në ASCAL dhe vizita në IAL konstatuam që institucioni ka hapësira të mjaftueshme si: salla leksioni të pajisura me mjete audiovizive, salla seminaresh, laboratorë informatike dhe të kontabilitetit financiar, sallë konferencash, bibliotekë, palester, ambiente për pushim të studenteve etj., të cilat mundësojnë realizimin e PS.</p> <p>Sallat e leksioneve e seminareve janë të pajisura me</p>

<p>mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>të gjitha mjetet e përshtatëshme për një proces mësimor efektiv, duke respektuar të gjitha standardet.</p> <p>Në funksion të programit të studimi janë dy laboratorë, laborator i informatikës dhe i kontabilitetit të kompjuterizuar.</p> <p>Labororet kanë pajisjet e nevojshme dhe programet kompjuterike në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Përveç paketës office më të cilën punohet në informatikë, në laborator janë të instaluar dhe dy programe profesionale për kontabilitetin: "Financa 5" dhe "Alpha".</p> <p>Pjesë e programit mësimor është dhe praktika profesionale, 2 javë në semestrin e VI. Për periudhën 2012-2018 KU "Logos" ka lidhur disa marrëveshje me biznese, studio kontabiliteti, banka, kompani sigurimi dhe telekomunikacioni, për të mundësuar praktikat profesionale të studentëve. Marrëveshjet e lidhura garantojnë zhvillimin normal të praktikave profesionale.</p>
---	--

### **Konkluzione të GVJ:**

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

- ✓ KU "Logos" ka siguruar infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor;
- ✓ Në dispozicion të studentëve është biblioteka, e cila disponon litaraturë bazë dhe ndihmëse në funksion të mësimdhënies në këtë PS, *por vetëm një pjesë e vogël e literaturës ndihmëse, është në funksion të programit të studimit.* Biblioteka pasurohet në mënyrë periodike, me literaturë në funksion të programit të studimit. Studentët mund të aksesojnë literaturë online, e cila mundësohet nga bashkëpunimi i KU me Universitetin e Pireut;
- ✓ Në dispozicion të PS janë dy laboratore, të cilat kanë të gjitha pajisjet dhe programet e nevojshme kompjuterike.
- ✓ Në shërbim të studentëve dhe personelit ka gjithashtu hapësira për shplothje dhe zbatimje.

#### Rekomandim:

*Të pasurohet biblioteka me literaturë ndihmëse në funksion të programit të studimit.*

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.*

KU Logos konsiderohet institucion jofitimprures sipas dokumentacionit nga pikpamja financiare. Ai funksionon juridikisht dhe financiarisht brenda Fondacionit Logos. Pasqyrat financiare

përgatiten nga fondacioni dhe jo në mënyrë individuale si KU. Statusi jofitimprues reflektohet në tarifatat e ulëta të shkollimit për të gjitha programet e studimit. KU "Logos" ofron bursa e ndihma financiare për studentet, veçanërisht për studentët me aftësi ndryshe. (Ref RVB fq. 37).

Burimet e të ardhurave janë: të ardhurat nga tarifatat e shkollimit të studenteve; financimi nga Fondacioni Logos; financime e donacione të tjera që nuk bien në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Tarifa e shkollimit në ciklin e parë të studimit është 150.000 lekë në vit dhe paguhet nga studentët në tre këste çdo vit. Pasqyrat financiare janë për Fondacionin "Logos" dhe nuk mundësojnë analiza të veçanta për këtë program studimi.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):**

Programi i studimit financohet kryesisht nga dy burime:

- *Tarifatat e shkollimit.* KU "LOGOS" nuk ka të dhëna mbi përqindjen e të ardhurave që sigurohet nga ky burim.
- *Donacionet nga Fondacioni "Logos" dhe donacione të tjera të ligjshme.* Për të gjitha vitet e raportuara pjesa më e madhe e të ardhurave vjen nga donacionet. Në vitin 2017-2018 të ardhurat nga donacionet janë 3.2 herë më të mëdha se në vitin 2012-2013. (Aneks Tabela 8)

Në raportin e auditit u konstatua që të ardhurat jepen të detajuara për vitin 2016 dhe 2017. Për këto dy vite të ardhurat janë rreth 50 milionë lekë dhe të ardhurat nga pagesat vjetore të studentëve të ciklit të parë zënë respektivisht 86.8% dhe 89.2% të të ardhurave totale. (Aneks 9.1)

##### **Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Kosto e studimit për student në vitin akademik 2017-2018 është 250,000 lekë ose rreth 66.7% më e madhe se tarifa e shkollimit. Kosto për student ka patur luhajtje gjatë periudhës 2012-2018. Sipas RVB në llogaritjen e koston për student përfshihen vetëm shpenzimet operative si: paga, sigurime shoqërore, energji elektrike, ujë, telefon, shpenzime kancelarie etj. Ndërsa, shpenzimet kapitale, apo për aktive afatgjata si: zgjerime të sipërfaqes së shfrytëzueshme, palestra, pajisjet laboratorike, etj, mbulohen nga Fondacioni Logos. Këto shpenzime nuk merren parasysh në llogaritjen e koston për student. Për vitin 2017 shpenzimet për aktivitetin mësimdhënës kanë qënë 48.0% më të mëdha sesa të ardhurat. (Aneks 9.1)

##### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Gjatë vizitës në institucion nuk u kërkua dokumentacion shtesë.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Fondacioni Logos bën auditim të jashtëm çdo vit. Raportet e auditit paraqesin situatën financiare për të gjithë aktivitetin e fondacionit, por nuk ka një raport të veçantë për KU "Logos".</p> <p>Pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të. Në pasqyra paraqiten të gjitha detyrimet financiare afatshkurtëra dhe afatgjata të Fondacionit.</p> <p>Raporti i audit ka një pasqyrë të qartë me të gjitha burimet e të ardhurave.</p> <p><b>(Aneks 9.1, Aneks 9.2, Aneks 9.3, Aneks 9.4)</b></p>
--	--

## VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

### Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Për vitet financiare 2016 dhe 2017 Fondacioni "Logos" ka pasqyra të hollësishme financiare, ku reflektohen të ardhurat nga tarifat vjetore, të ardhurat nga provimet përsëritëse, pagesat për diplomat, të ardhurat nga pagesa e programeve të studimit, etj.</p> <p><b>(Aneks 9.1 pasqyrat 2017, fq.14)</b></p> <p>Fondacioni Logos ka raporte financiare të çertifikuara nga auditues të jashtëm për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve. <b>(Aneks 9.1 deri në Aneks 9.4)</b></p> <p>Për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve Fondacioni Logos ka financuar aktivitetin e KU. <i>Të ardhurat nga aktiviteti mësidhënës nuk mbulojnë shpenzimet.</i> Qëndrueshmëria financiare e KU "Logos", përcaktohet nga qëndrueshmëria financiare e Fondacionit "Logos".</p>
---	---

### Konkluzionet e vlerësimit:

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

- ✓ Fondacioni Logos ka statusin orgnizatë jofitimprures. Fondacioni e dokumenton aktivitetin e tij përmes pasqyrave financiare, të cilat janë audituar nga auditues të jashtëm, për të gjithë periudhën midis dy akreditimeve.
- ✓ KU "Logos" funksionon si pjesë e Fondacionit Logos dhe nuk përgatit pasqyra financiare të veçanta. Statusi si institucion jofitimprures, reflektohet në tarifat e ulëta të shkollimit për të gjitha programet e studimit. *Shpenzimet për aktivitetin mësimdhënës janë rreth 48.0% më të mëdha se totali i të ardhurave që sigurohen nga aktiviteti mësimdhënës.*
- ✓ Qëndrueshmëria financiare e KU "Logos", është e ndërvaruar nga qëndrueshmëria financiare e Fondacionit "Logos".

Rekomandim:

*Për të rritur qëndrueshmërinë dhe zgjeruar aktivitetin mësimor dhe kërkimor do të sugjeronimin që tarifat duhet të barazohen gradualisht me kostot.*

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

KU Logos ka ngritur NjsBC (Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 dhe statutit të institucionit. Referuar RVB kjo zyrë është krijuar për herë të parë me vendimin Nr. 11, datë 07.11.2011 të Senatit Akademik, ndërsa veprimtaria dhe/ose përbërja e saj ka ndryshuar me vendimet pasuese të Senatit Akademik në vitet 2014, 2015 dhe 2018. NjsBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të personelit akademik, organizon punën për tërheqjen e mendimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, në fund të çdo semestri, kryen studime për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve, etj. Standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga KU "Logos", në përputhje me Kodin e Cilësisë.

#### **(Aneks 3.1.2, kreu VIII, fq.23-24)**

Senati Akademik me vendimin Nr.43, datë 08.02.2018 ka miratuar krijimin në nivel institucional të grupit të punës për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, të përbërë nga 6 anëtarë, nga të cilët 1 është ekspert i jashtëm dhe 1 student. Senati akademik ka vendosur të funksionojë NJSBS edhe në nivel të Njësisë kryesore (Fakultetit). Në Fakultetin Ekonomik kjo njësi do të përbëhet nga 5 persona, nga të cilët 2 janë studentë. *Aktualisht funksionon vetëm NJSBC në nivel institucioni.*

#### **(Aneks 1.9)**

NJSBC ndjek në vazhdimësi zbatimin e procesit të mësimdhënies dhe realizimin e punës kërkimore shkencore. Synimi i punës së NJSBC në nivel të Njësisë kryesore ka qenë monitorimi, në dobi të ngritjes së nivelit të mësimdhënies e të punës kërkimore shkencore. NJSBS ka përdorur metoda vlerësimi të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për monitorimin, rezultatet e të cilave janë përmbledhur, diskutuar dhe bërë publike. **(Ref. RVB, fq 41, Aneksi 6.1).**

Pjesë e punës së NJSBC janë anketimet e përvitëshme të studenteve, përpunimi i të dhënave të pyetësorëve dhe analiza e rezultateve në departament dhe në mbledhjet e stafit akademik. Rezultatet e anketimit iu bëhen të njohura palëve të interesuara dhe titullarave të institucionit. Analizat e bëra nga NJSBS i shërbejnë gjithashtu procesit të raportimit për çdo vit akademik.

**(Ref RVB, fq 41, Anekset 6.2, 6.3, 6.4, 6.5).**

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### **Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit**

Referuar të dhënave të RVB, dokumentacionit të dorëzuar në ASCAL dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që anketimet e studentëve janë zhvilluar gjatë gjithë periudhës midis dy akreditimeve duke filluar nga viti 2011. Me studenët realizohen dy anketime në fund të çdo



semestri. **(Aneks 6.2, 6.3, 6.4, 6.5)** Anketimet realizohen për module dhe pedagogë të veçantë dhe janë anonime. Pyetësi plotësohet me dorë, por synohet të bëhet elektronikë. Numri i studentëve që kanë marr pjesë në anketim ka qënë në varësi të pjesëmarrjes në auditor. Kështu në vitin akademik 2016-2017 kanë marrë pjesë në vlerësimin e modulit të Mikroekonomisë 31 nga 42 studentë, ose 75.6% e studentëve. **(Aneks 6.4)**

Pyetësorët përpunohen të gjitha me një program statistikor. Studentët pyeten për performancën e pedagogëve në auditor, për qartësinë e shpjegimit, mënyrën e përcjelljes së njohurive tek studentet, metodat interaktive që përdorin pedagogët për ta bërë modulën me tërheqës, etj. Nga të dhënat e përpunuara **(Aneks 6.2 – 6.5)** rezulton që vlerësimet e studentëve për të gjitha këto karakteristika kanë qënë pozitive. Shkalla e vlerësimit është nga 1 deri në 5 dhe pjesa më e madhe e personelit akademik është vlerësuar mbi 4. Rezultatet e përpunuara i kalohen Rektorit dhe titullarëve të Njesisë Kryesore (Dekanit) dhe Njesisë Bazë (Përgjegjës Departamenti). Gjetjet diskutohen në nivel departamenti. Studentët nuk informohen për gjetjet e anketimit. Gjetjet e pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve vjetore.

**Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

KU "Logos" ka krijuar NJSBC në nivel institucioni. Në tabelën 9 tek anekset në fund të RVJ paraqiten anëtarët e NJSBC, pozicioni i tyre në NJSBC dhe koha në këtë detyrë. Në vitin akademik 2017-2018, njësia ka funksionuar me 7 antarë.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

NJSBC është përgjegjëse për organizimin e procesit të vetëvlerësimit në të gjitha Njesisë Bazë të KU. Ajo administron të gjitha instrumentat për procesin e vetëvlerësimit, përpunon të dhënat dhe harton raporte. Kjo njësi punon ngushtësisht me departamentet, njësinë e kurrikulave, zyrën e karrierës, etj. Ajo formulon mendime dhe propozime për plotësimin e standarteve të cilësisë në programet e studimit.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

KU "Logos" ka hartuar raporte të vetëvlerësimit në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit institucional. Departamenti Financë-Kontabilitetit ka hartuar dy raporte vetëvlerësimi për këtë program studimi.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Sigurimi i cilësisë është përcaktuar si prioriteti strategjik për periudhën 2018-2024 nga KU "Logos". Objektivi kryesor është përcaktuar përmbushja e të gjitha standardeve të cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe standardet Europiane të Arsimit të Lartë. Institucioni ka parashikuar disa masa që synojnë një vlerësim 360<sup>0</sup> të të gjithë veprimtarisë së institucionit. **(Aneks 95, fq.28-29)**

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

1. Politika për sigurimin e cilësisë
2. Rregullore për sigurimin e cilësisë
3. Formularë NJSBC 2019

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>KU "Logos" ka miratuar politikën dhe rregulloren për sigurimin e cilësisë. Në këto dokumenta janë përfshirë metodologjia, procedurat dhe gjithë instrumentat që do të përdoren për sigurimin e cilësisë. këto dokumenta janë miratuar në vitin 2019. <b>(Aneksi 3.1, 3.2 dhe 3.3 vizita në IAL))</b></p> <p>Nga RVB dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi që informacioni i mbledhur përmes pyetësorëve është përdorur nga NJSBC për të hartuar raportet e vetëvlerësimit.</p> <p>Nga takimet me personelin akademik dhe atë drejtues konstatuam që rezultatet e vlerësimit diskutohen në dekanat dhe departament. Personeli akademik informohet për rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit merren si bazë për të përcaktuar synimet për vitin akademik pasardhës. Rezultatet e pyetësorëve nuk iu komunikohen studentëve, por me ta diskutohet për problematikat që rezultojë nga procesi i vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p>	
<p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Nga takimet me personelin akademik dhe atë drejtues konstatuam që rezultatet e vlerësimit diskutohen në dekanat dhe departament. Personeli akademik informohet për rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit merren si bazë për të përcaktuar synimet për vitin akademik pasardhës. Rezultatet e pyetësorëve nuk iu komunikohen studentëve, por me ta diskutohet për problematikat që rezultojë nga procesi i vlerësimit.</p>
<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>KU "Logos" përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit. Ndër metodat e tërthorta përdoren vetëm pyetësoret e studenteve. Metodat e drejtpërdrejta përdoren më shumë për kryerjen e vlerësimit, por të dhënat që grumbullohen nga këto metoda nuk paraqiten në mënyrë të sintetizuar nga institucioni. Elementë të metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit i gjejmë në syllabuset emoduleve.</p> <p><b>(Ref RVB, fq 43, Aneksi 4.1).</b></p>
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të</b>	

## studimeve.

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

KU "Logos" ka kryer procedurat e akreditimit institucional dhe bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 95, dt. 20/10/2017, institucioni është akredituar për një kohëzgjatje 3 vjeçare me afat vlefshmërie deri më datë 19.10.2020 ndërkohë që ka aplikuar për akreditimin e programit të studimit në 21.03.2018. Aplikimi për akreditimin e programit është kryer pas akreditimit institucional.

Sipas RVB dhe vizitës në institucion konstatojmë që KU "Logos" përdor dy instrumenta për të vlerësuar dhe monitoruar punën e stafit akademik. Përmes sistemit elektronik personeli akademik raporton për realizimin e objektivave në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Të dhënat e raportura ballafaqohen me objektivat, dhe mbi bazën e tyre prodhohen raportet e realizimit të detyrave nga personeli akademik. Nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstatojmë që KU Logos merr në çdo semestër mendimin e studenteve për mësimdhënien përmes pyetesoreve. Ky proces drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC, e cila përpunon dhe bën publike të dhënat. **(Aneksi 6.2 ÷ 6.5).**

KU "Logos" ka procedura të vlerësimit periodik për vlerësimin e personelit akademik, infrastrukturës në dispozicion të mësimdhënies.

KU Logos ka krijuar mekanizmat e duhur për kontrollin e sigurimit të cilësisë.

NJSBC përdorë mekanizma formalë si:

- pyetësorët e studentëve;
- pjesëmarrjen në leksionet e hapura;
- vetëvlerësimin e personelit akademik;
- standartizimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve për të mbikëqyrur PS;

Nga takimi me grupin e NJSBC dhe informacionin e marr mbi punën që kryen, GVJ konstatoi që IAL i ka dhënë mbështetjen dhe mjetet e nevojshme kësaj njësie për të realizuar funksionet e saj. Kjo njësi ka siguruar gjithashtu bashkëpunimin e departamenteve, zyrës së karrierës dhe kërkimit shkencor në veprimtarinë e saj.

Senati akademik ka miratuar dokumentin "Politikat për sigurimin e cilësisë", i cili shërben për të udhëhequr vendimet dhe orientuar procesin e sigurimit të cilësisë. Përmirësimi i cilësisë është

adresuar në Planin Strategjik 2012-2017 dhe është nxjerrë si prioriteti strategjik edhe për periudhën 2018-2024 .Dokumentat janë publike. (**Aneks 3.2, Aneks 3.3 Vizita IAL, Aneks 3.6, fq. 18-19 dhe Aneks 92, fq. 27-28).**

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

- ✓ KU "Logos" ka hartuar dhe miratuar politikat dhe rregulloren për sigurimin e cilësisë. Dokumentet përmbajnë metodologjinë e vlerësimit, procedurat dhe instrumentat që përdoren për vlerësimin e programeve të studimit.
- ✓ Informacioni i mbledhur përmes instrumentave të ndryshëm përpunohet, gjetjet bëhen të njohura për drejtuesit dhe personelin akademik dhe përdoren për të hartuar raportet e vetëvlerësimit;
- ✓ GVJ konstatoi që KU "Logos" ka ndjeshmëri në drejtim të sigurimit të cilësisë të programeve të studimit dhe ka përcaktuar sigurimin e cilësisë si prioritet strategjik për institucionin për periudhën 2018-2024.

### **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

#### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

##### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

Programi i studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet organizohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit, i cili është baza e mbështetjes akademike të këtij programi. Objektivi i këtij programi është të përgatisë profesionistë në fushën e financës e të kontabilitetit, duke i vënë studentet në mjedise reale të zhvillimit të biznesit, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. (**Ref. RVB, fq.9**). Departamenti ka përcaktuar lëndët e detyrueshme dhe lëndët me zgjedhje për programin e studimit.

Objektiv i rëndësishëm i këtij programi është të përgatitë specialistë finance e kontabiliteti për kompanitë e biznesit, për sistemin bankar e financiar, për deget e tatim taksave e të sistemit doganor, për auditimin e kontrollin, për tregjet financiare e bursave, specialistë të aftë për shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit e fondet e investimeve, të krijojë figurën e ekspertit në fushën e financave e të kontabilitetit. (**Ref. Aneks Fq.2**)

Programi studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është me kohe të plotë dhe konsiderohet i përfunduar kur plotësohen 180 ECTS. (**Ref. RVB, fq. 10 e RVB, Aneks 3.1.1, nenet 27÷29, Aneks 3.2.2** ).

Plani mësimor është i ndarë në 6 fusha sipas veprimtarise formuese të studenteve, përfshirë edhe tezën. Peshën me të madhe sipas krediteve e zenë veprimtari në disiplina të formimit karakterizues gjithsej 48 kredite, si praktika dhe teza 12 kredite.

(Aneks 4.1, fq.4).

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi i studimit Bachelor ne Finance Kontabilitet është licensuar me Urdhërin Nr.1, datë 06.01.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Viti i fillimit të këtij programi është 2010-2011. Akreditimi i parë i ketij programi është bërë në korrik 2012 dhe procesi i akreditimit periodik fillon në vitin 2018-2019. (RVB, fq. 47).

**Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

- |                           |   |
|---------------------------|---|
| ➤ 1 vit akademik ka       | <b>3 vite/6semestra /30 javë mësimore në auditor</b>          |
| ➤ 1 Semestër ka           | <b>13/15 javë mësimore në auditor</b>                         |
| ➤ 1 vit akademik ka       | <b>768 ore mësimore në auditor</b>                            |
| ➤ 1 semester ka           | <b>384 orë mësimore në auditor për një lëndë.</b>             |
| ➤ 1 ETCS =                | <b>25 ore mesimore te punes se pergjithshme per studentin</b> |
| ➤ 1 ore mesimore (mesimi) | <b>60' minuta</b>   |

**Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Plani mësimor është i organizuar në 6 semestre, ku semestri i fundit i lihet praktikës mësimore dhe tezës. Plani mësimor është i organizuar në 6 fusha veprimtarie, ku veprimtari si disiplina të formimit karakterizues (A), zënë 39 kredite, veprimtaria B zë 85 kredite, veprimtaria C 20 kredite, veprimtaria E, pra lëndë të formimit të përgjithshëm zënë 26 kredite dhe teza zë 6 kredite. (RVB Tab 11, fq 51).

Sipas (Aneks 4.1) vihet re një ndryshim krahasuar me RVB në raportet e krediteve sipas disiplinave si më poshtë: veprimtari si disiplina të formimit karakterizues (A), zënë 38 kredite, veprimtaria B zë 86 kredite, veprimtaria C 21 kredite, veprimtaria E, pra lëndë të formimit të përgjithshëm zënë 26 kredite dhe teza zë 6 kredite.

Sipas këtij informacioni vërehet se i është vënë me shumë rëndësi disiplinave të formimit te përgjithshëm dhe disiplinave të formimit karakterizues, pasi ato zënë 124 kredite. Vihet re se lëndët e disiplinave të formimit të përgjithshëm kanë peshë të njëjtë, me 6 kredite, po kështu edhe për pjesën me të madhe të disiplinave të formimit karakterizues. Lëndet me zgjedhje janë me nga 4 kredite, janë caktuar vetëm nga 2 lëndë me zgjedhje për çdo semester.

**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (RVB fq 50):**

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret / ushtrimet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

- Për Praktikën Profesionale 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Sipas fq 52 Tab 12 RVB)**

Nga **Tabela 12 e 12.1 e RVB**, të cilat kanë për qëllim të tregojnë ndryshimet e ECTS për lëndët sipas vitit të fundit akademik në krahasim me programin e licensuar, vërejmë se këto ndryshime përfshijnë 30 ECTS. Sipas analizës së të dhënave të kësaj table shihen këto ndryshime.

Për periudhën 2011-2014 janë 34 lëndë plus praktika mësimore 35 lëndë gjithsej. Jane shtuar 15 kredite për 12 lëndë, janë hequr 13 kredite për 5 lëndë, pra shtohen 2 kredite në total.

Është hequr lënda "*Kontabilitet financiar 1*" që kishte 4 kredite dhe është shtuar lënda "*Kontabilitet financiar 2*" me 7 kredite.

Janë ndryshuar lëndë me zgjedhje, kështu, nga lëndët "*Komunikim biznesi/Sjellje organizative*" me 3 kredite, u ndryshuan në "*Histori e mendimit Ekonomik/Marredhënie me publikun*" me 2 kredite.

Praktika mësimore nga 4 kredite u bë me 6 kredite. Në tërësi vërehet se rritjet apo uljet në kredite janë shoqëruar me rritje apo ulje të orëve të mësimi.

P.sh., në lëndën "*E drejtë Biznesi*", lëndë e vitit të parë semestri i dytë, nga 6 kredite, i janë akorduar 4 kredite, nga 150 orë në total, i janë lënë 100 orë, nga të cilat 45 orë mësimi në auditor dhe 55 orë pune e pavarur e studentit.

**Bilanci i krediteve të shtuara dhe pakësuara për lëndët ekzistuese është 2 kredite shtësë, pra kanë ndodhur 1,4 % ndryshime në krahasim me programin e licensuar, përqindje e cila është brenda limitit që ka institucioni për ndryshimin e këtij programi.**

Për periudhën 2014-2016 sipas tabelës 12/1 rezulton se ka ndryshime vetëm në dy lëndë: "*Matematika ekonomike*" ishte 4 kredite, bëhet 5 kredite, duke rritur kreditet e leksionit nga 1 në 3, e duke ulur kreditet e seminarit nga 3 në 2 e duke ulur dhe orët e seminarit nga 45 në 20 orë. Ka ndryshim edhe në lëndën "*Manaxhim i Burimeve Njerëzore*" nga 3 në 2 kredite, duke ulur kreditet e leksionit nga 2 në 1, por pa ndryshuar orët e mësimi.

Në tërësi mund të thuhet se ndryshimet që kanë ndodhur në planin mësimor konsistojnë në: respektimin e objektivave kryesorë të programit, riorganizimin e paraqitjes së planit mësimor me 22 lëndë, të cilat sic dihen mbyllen me provim përfundimtar dhe me module, të cilat mbyllen me vlerësim semestral, në uljen e orëve të disa lëndëve të caktuara, duke respektuar kriterin 20-25 orë fizike në javë, për 15 javë mësimore në semestër, në heqjen e disa lëndëve dhe zëvendësimin e tyre me lëndë të tjera në përputhje me kërkesat e tregut, për të qenë sa më afër me objektivet e programit të studimit, kanë ndodhur spostime të ndonjerës prej lëndëve për t'iu përgjigjur më mirë logjikës së lëndëve, për të ruajtur renditjen në kohë të zhvillimit të planit mësimor, po kështu ndryshimet kanë lidhje edhe me rishikimin e vlerësimit të krediteve të disa lëndëve, sic ishte rasti i lëndës E drejtë Biznesi, më lart, etj.

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Sipas Tab 13 RVB fq 58)**

Sipas Tabeles 8 të RVB e (Anekseve 5.1, 5.3, 5.4 ) e (dokumentit 92) jepet shpërndarja e pedagogëve sipas lëndëve të Programit Bachelor Financë Kontabilitet si dhe ngarkesa e pedagogëve në semestrin e parë dhe të dytë të këtij programi.

Në vitin e parë bachelor ka vetëm një lëndë “Parimet Bazë të Kontabilitetit”, që zhvillohet nga pedagoge e brendshme dhe pedagoge e ftuar, 60 orë gjithsej.

Në vitin e dytë zhvillohen katër lëndë nga pedagogë të departamentit të Financë Kontabilitetit nga tre pedagogë të brendshëm.

Në vitin e tretë zhvillohen 10 lëndë nga 3 pedagogë të brendshëm e 4 pedagogë të ftuar. Vitin e parë zhvillohet vetëm 2 orë në javë mësim në lëndë të Departamentit të FK, konkretisht lënda “Parimet Bazë të Kontabilitetit”, Vitin e dytë zhvillohen 4 lëndë të departamentit të Financë Kontabilitetit, që mbulohen nga dy pedagogë të brendshëm dhe një pedagoge e jashtme, dhe rezultojnë se kanë zhvilluar 3 orë në javë mësim në këto lëndë, ndërsa në vitin e tretë, ku sic u shprehëm më lart zhvillohen 10 lëndë të departamentit FK, që mbulohen nga 3 pedagogë të brendshëm dhe 4 pedagogë të ftuar, rezultojnë se ngarkesa është 2 orë/javë.

Nga këto shifra mund të shprehemi se pedagogët e brendshëm të departamentit nuk kanë ngarkesë të lartë në auditor në lëndët e ciklit të parë.

Nga shqyrtimi i CV të stafit me kohë të plotë të angazhuar në programin Bachelor në Financë Kontabilitet shihet se të gjithë pedagogët, pra 7 të angazhuar në procesin mësimor, kanë CV të plota dhe karriere profesionale dhe akademike të përshtatshme për lëndet në të cilat ata ishin të anagazhuar. Në CV e tyre është **pasqyruar eksperiencën në mësimdhënie si dhe botime shkencore të kryera** prej tyre.

Prej informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, po kështu sipas CV-ve të pedagogëve të brendshëm dhe të ftuar, rezultojnë se pedagogët janë rekrutuar në përputhje me fushën e studimit dhe lëndën përkatëse sipas planit mësimor, të miratuar në KU Logos, për të realizuar objektivat e programit të studimit. Duke iu referuar edhe **(tabelës 12/1 të RVB)** vërehet se çdo staf akademik i rekrutuar plotëson kriterin e përputhshmërisë së kualifikimit të tij me kërkesat e lëndës, planit mësimor, programit të studimit. Pedagogët përveç diplomës së fituar kanë patur kualifikime jashtë vendit, brenda vendit, kanë marrë pjesë me punime në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, sipas **(Aneksit 5.9, 5.11, 5.12)**, për të rritur nivelin shkencor e profesional. Sipas anekseve të përmendura më lart, rezultojnë se gjatë periudhës nga akreditimi i parë e deri më sot, Departamenti i Kontabilitetit i KU Logos, ka rekrutuar 7 pedagogë (staf akademik) efektiv, në plotësim të kriterëve të caktuar nga Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Ka patur lëvizje të stafit akademik ndërmjet departamenteve, por jo vetëm, por numri i pedagogëve ka qenë 7. Vetëm në këtë vit akademik, 2018-2019, numri i stafit akademik të brendshëm është 6. Për realizimin e planit mësimor të këtij viti akademik, janë rekrutuar më shumë pedagogë të ftuar.

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

Syllabuset janë paraqitur me të gjithë elementët përkatës:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën

- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe intervistave të kryera me stafin akademik, u vlerësua roli që kishte udhëheqësi i çdo lënde në ndërtimin e syllabuseve dhe në rishikimin e tyre. U konstatua se syllabuset rishikohen dhe diskutohen në departament çdo fillim viti akademik. ku theksohet nëse ka ndryshime ose jo dhe në çfarë mase është ky ndryshim. Çdo pedagog udhëheqës i lëndës rishikon e përmirëson syllabusin, me qëllim që studentët të marrin informacionin e nevojshëm për t'u siguruar një formim profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Miratimi i syllabuseve bëhet nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekani. Forma e syllabuseve ishte standarte për të gjitha lëndët dhe ishte e publikuar në faqen e programit. Në hartimin e syllabuseve respektohet formati tip sipas ASCAL dhe liria akademike. Syllabusi përmban këta elemente kryesore:

- Kodin e lëndës
- Numrin e krediteve
- Emrin e pedagogut udhëheqës të lëndës
- Përshkrimin e lëndës
- Objektivet e lëndës
- Temat që përmban lënda
- Tekstin kryesor dhe literaturën mbështetëse
- Referenca të tjera literature
- Rezultatet dhe qëllimi i programit të lëndës
- Metodot e vlerësimit dhe pesha e tyre.


Metodat e vlerësimit ishin të ndryshme dhe përcaktoheshin individualisht nga çdo titullar i lëndës. Kështu për shembull në sillabusin e lëndës "Parimet Bazë të Kontabilitetit" pesha e provimit përfundimtar ishte 60%, kundrejt 40% që ishte pesha e të gjitha metodave të tjera të vlerësimit si kolokiumi i ndërmjetëm 30%, pjesmarrja në leksione e seminare 10%, etj. (**Aneks 94**).

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Ngarkesa totale e stafit akademik të programit BA Financë Kontabilitet

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është licensuar me Urdhërin Nr.1, datë 06.01.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, pranë Kolegjit Universitar Logos. Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është akredituar për herë të parë në vitin 2012. Ky program është i organizuar me module të vlerësuara
<b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që	





<p>ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>me kredite të transferueshme dhe të aplikuara për studentët që kanë të transferuara kreditet e tyre si në universitetet e tjera brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij.</p> <p>Ky program studimi është me 180 kredite dhe ofrohet në tre vite me 6 semestra. Për çdo vit me kohë të plotë jepen mesatarisht 60 kredite (RVB fq. 66).</p>
---	--

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.**

<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>	<p>Programi studimit Bachelor në Financë Kontabilitet zhvillohet në përputhje me strategjinë e institucionit dhe në vecanti të këtij program studimi, për t'i përgatitur studentët me njohuritë e duhura në përputhje me nevojat e tregut. Informacioni jepet në forma të ndryshme: nga pedagogu i lëndës, në guidën e universitetit, website i universitetit etj, Pedagogu i çdo lënde e zbërthen programin në orën e parë të mësimit, duke i dhënë studentit informacion të plotë për lëndët me zgjedhje, njohuritë formuese që merr si dhe për lëndët e detyruara që zhvillohen për çdo semestër.</p> <p>Në programin e studimit paraqiten në mënyrë të detajuar: ngarkesa mësimore, orët në auditor, frekuentimi i procesit mësimor. Që të jetë kalues në një lëndë/modul studenti, duke iu referuar syllabusit të lëndës, rregullores së Departamentit dhe të Programit të Studimit, duhet të frekuentojë rregullisht 75% të ngarkesës mësimore në atë lëndë/modul, në të kundërt skualifikohet.</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde/moduli studenti gjen informacionin e nevojshëm për faktin nëse lënda/moduli është e detyrueshme apo me zgjedhje, kreditet, përfitimet nga lënda, temat që do zhvillohen, mënyrën e vlerësimit të dijeve, orët që përmban lënda/ moduli për zhvillimin e leksioneve, të seminareve, të praktikës profesionale, po kështu njihet me literaturë të detyrueshme dhe atë plotësuese etj.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>	
<p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

✓ Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hartuar në përputhje me misionin e objektivat e përcaktuara në aktet ligjore për arsimin e lartë në RSH, dhe në

direktivat e BE për arsimin e lartë;

- ✓ Departamenti përgjegjës ofron programin e studimit “Bachelor” të akredituar, të organizuar në lëndë/module dhe të vlerësuar në kredite, sipas sistemit europian të grumbullimit e të transferimit të krediteve (ETCS). Numri i krediteve të grumbulluara nga një student që ndjek programin e studimit bachelor në Finance Kontabilitet me kohë të plotë, është 180 kredite.
- ✓ Departamenti ofron informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programit të studimit, për lëndët e detyruara dhe me zgjedhje që ai përmban, për ngarkesën mësimore, frekuentimin e procesit mësimor, për leksionet, seminarët, si dhe praktikën profesionale si një element të rëndësishëm të procesit mësimor.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

Mësimdhënia në programin e studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Financë Kontabilitet është e organizuar me kohë të plotë, për 3 vite akademike dhe i vlerësuar me kredite europiane, 180 kredite (60 ETCS për çdo vit akademik). Format e organizimit të mësimdhënies në këtë program studimi janë leksione, seminare, teste të ndërmjetme, provimi përfundimtar, praktika profesionale, punë kërkimore për përgatitjen e tezës. **(Aneks 4.1 dhe RVB fq 67)**. Ngarkesa mësimore është 15 javë mësimore për semester dhe mesatarisht 22 orë javore fizike, duke respektuar kërkesat e Ligjit të Arsimit të lartë 80/2015.

Procesi mësimor mbëthetet nga një infrastrukturë e përshtatshme. **(Aneksi 10.1 dhe RVB fq 67)**. Staf i akademik, që përballon këtë ngarkesë, ka një nivel kualifikimi të përshtatshëm, të fituar brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kërkesat e LAL. **(Aneksi 5.1)**.

Kontrolli i njohurive të studentëve realizohet përmes diskutimeve në orët e mësimit, testit të ndërmjetem, praktikës profesionale dhe provimit të përgjithshëm përfundimtar/diplomës.

Në leksione gjatë shpjegimit përdoren edhe mjetet audiovizive, për të tëhequr sa më shumë vëmendjen e studentëve, për ta bërë mësimin interaktiv, ndërsa në seminare pedagogët përdorin metoda që zhvillojnë tek studentët shprehitë dhe kompetencat e tyre që do t'u vlejné në punën e tyre në të ardhmen. Pëvoja që kanë fituar pedagogët në kualifikimet e tyre jashtë vendit ka sjellë tek ata një ndryshim në stilin dhe metodën e mësimdhënies, ku prioritet ka nxitja e debatit gjatë orës së mësimit për probleme të ndryshme të lidhura me temën.

Pranë institucionit dhe Fakultetit Ekonomik, është ngritur dhe funksionon me vendim të senatit Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë (NJSBC), për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor. **(Aneksi 9.1 dhe RVB fq. 68)**. Për përmbushjen e detyrave NJSBC përdor metodologji vlerësimi dhe instrumenta matës për ecurinë e programit të studimit, si dhe metoda vlerësimi të tërthorta dhe të drejtpërdrejta **(Aneksi 6.1 dhe RVB fq 68)**. Kontrollët kryhen nga koordinatori i programit. Opinione të studentëve dhe NJSBC kanë vlerësuar procesin mësimor në nivel të kënaqshëm **(Aneksi 6.5)**

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

**Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet**

Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies sipas (Tab 14 të RVB dhe Aneksit), janë si vijon:

• Leksione	960 orë në auditor
• Seminare	1010 orë në auditor
• Ushtrime	0 orë në auditor
• Laboratore	0 orë në auditor
• Praktikë lëndore	0 orë në auditor
• Praktikë profesionale	125 orë në auditor
• Diplomë	25 orë në auditor
• Totali	<b>2120 orë në auditor</b>

**Format e kontrollit të njohurive**

Sipas rregullores mësimore të programit të studimit, planit mësimor e syllabuseve të lëndës, ka disa forma të kontrollit të njohurive. Duhet theksuar se pesha specifike e seciles nga këto forma të vlerësimit përcaktohet në syllabus dhe nuk është e unifikuar për të gjitha lëndët. Një shembull i formave të kontrollit të dijes është: ndjekja e lëndës e pjesmarrja përfaqësojnë 10% të vlerësimit, Testet gjatë vitit 30%, provimi përfundimtar 60% të vlerësimit.

(RVB, Tabela 10 fq. 68).

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Sipas RVB në Tabelën 16, jepen të dhëna për aktivizimin e studentëve në aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me pedagogë, departament apo fakultet. Sipas kësaj tablele studentët aktivizohen edhe në aktivitete të tjera përveç mësimin. Janë aktivizuar veçanërisht në punën shkencore individuale të pedagogëve, 14 studentë, në projekte shkencore në rang Departamenti 7 studentë, për projekte shkencore në rang Fakulteti janë angazhuar 5 studentë.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Gjatë vizitës në institucion nuk u kërkua dokumentacion shtesë

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.*

Pranimi i studentëve të rinj në programin e studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Financë Kontabilitet, bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, aktet nënligjore si VKM, Statutin, Rregulloren e Programit të studimit Bachelor. **(Aneksi 3.5).**

Pranimi i studentëve të rinj është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave apo që zotëron një diplomë tjetër studimi të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit.

Çdo studenti në regjistrimin fillestar i jepet një numër matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës. Kolegji Universitar Logos, mban regjister bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, regjistër për vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, regjistër grupi, të dhëna për diplomën, të formatuara sipas standarteve shtetërore. Regjistri i të dhënave personale dhe i vlerësimit të studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe ruhet në mënyrë të përhershme.

Kohëzgjatja normale e studimeve në këtë program studimi është tre vite akademike. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në këtë program nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

##### **Procedurat e pranimit të studentëve**

Pranimi në programin e studimit të Ciklit të parë Bachelor në Financë – Kontabilitet, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM apo që zotëron një diplomë tjetër studimi të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit. KU “Logos” i dërgon, në fillim të vitit akademik, Qendrës Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar. Dokumentat e nevojshme për regjistrim janë sipas **(Aneksi 3.5)**

U përzgjedhën në mënyrë rastësore dy dosje të studentëve, ku u konstatua se përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

##### **Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Cilësia e studentëve në hyrje në programin e ciklit të parë bachelor në Financë Kontabilitet është mesatare. Nota mesatare ka luhatur nga 6.14 në vitin akademik 2011-2012, në 7,6 në vitin 2015-2016, e më pas në 6,4 në vitin 2017-2018. **(RVB, Tabela 17 fq.71).**

##### **Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore rezultoi se studentë të regjistruar për herë të parë për të gjithë ciklin e studimit (tre vitet e fundit) janë gjithsej **28 studentë**, me një notë mesatare 7.5 konkretisht:

Për vitin akademik 2016 – 2017	<b>12 studentë</b> të regjistruar për herë të parë;
Për vitin akademik 2017 – 2018	<b>7 studentë</b> të regjistruar për herë të parë dhe <b>2</b> të transferuar;
Për vitin akademik 2018 – 2019	<b>7 studentë</b> të regjistruar për herë të parë;

Për të dhëna të hollësishme lidhur me studentët, **shih Tabelën 11 në Aneks.**

##### **Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Sipas RVB Tabela nr. 18, numri total i të diplomuarve në këtë program studimi për periudhën 2012 – 2018 është **139 studentë**.

**☑ Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Sipas RVB, Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si pjesë e tij, ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda Fakultetit Ekonomik, apo Institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend. Periudha e studimit dhe detyrimet e programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Financë Kontabilitet, të shlyera në institucione të tjera të vendit, njihen e njehsohen për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm në Fakultetin Ekonomik të KU “Logos”. Transferimi lejohet brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesëshme të krediteve të fituara nga një student, i takon komisionit përkatës të ngritur nga Departamenti Financë Kontabilitet i Fakultetit Ekonomik, sipas Vendimit të Senatit nr. 7, datë 27.10.2014. **(Aneksi 1/2)**

**☑ Të dhëna për punësimin e studentëve**

Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe RVB lidhur me punësimin e studentëve, nga ana e zyrës së karrierës ndiqet ecuria e studentëve dhe integrimi i alumni në tregun e punës. Konstatohet se ky informacion është i plotë e dinamik.

Sipas **tabeles 18 të RVB**, në këtë program studimi janë diplomuar në total për periudhën 2012-2018, 139 studentë, nga të cilët 90 janë punësuar në përputhje me diplomën, ndërsa 30 prej tyre janë punësuar jo në përputhje me diplomën. Mbeten të pasistemuar 19 studentë.

**☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Aneksi 7/17 Analiza e punesimit te studenteve te Fakultetit Ekonomik

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Kriteri minimal për pranimin e studentëve në Ciklin e Parë të studimeve Bachelor është të kenë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe të kenë plotësuar kriteret e pranimit të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, pra bëhet në përputhje me ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në dokumenta të brendshme të funksionimit të IAL si: Statutin, Rregulloren e Përgjithëshme të KU “Logos” dhe Rregulloren mësimore të programit “Bachelor”.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin	Studentët e programit bachelor marrin gjithë informacionin e duhur në lidhje me programet e

<p>dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme të institucionit, procedurat për aktivitete të ndryshme të procesit mësimor etj. Nga takimet e vizita në institucion GVJ konstatoi se dokumentacioni i pranimit të studentëve është i plotë e i rregullt, pasi u përzgjedhën dosjet e dy studentëve me zgjedhje të rastësishme nga ana e GVJ. (<b>Aneksi 3/1,2,5 Statuti i KU “Logos”, Rregullore e Pergjithëshme e KU “Logos”, Rregullore e Programit të Studimit</b>).</p> <p>Në fund të semestrit studentët bëjnë vlerësimin e pedagogut të çdo lënde. Ky proces realizohet përmes pyetësorëve të hartuar nga NJSBC-ja, të cilat analizohen për të nxjerrë detyra për përmirësimin e punës në të ardhmen.</p> <p>Nga kontaktimi me studentët u konkludua se ata ishin të mirëinformuar për procesin e akreditimit dhe ishin të përfshirë në këtë proces.</p> <p>Shërbimi i këshillimit të karrierës ishte i ngritur dhe funksional. Sistemi informatik i përdorur nga universiteti i lejon të mbajnë kontakte me alumni edhe pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Zyra e këshillimit të karrierës si dhe pedagogu tutor i caktuar për studentet, informojnë studentët për politikën e punësimit. Lidhjet e institucionit me kompanitë e biznesit, mundësojnë praktikën profesionale, si dhe krijim të mundësive të punësimit pas diplomimit (<b>Aneks 8.2</b>).</p>
---	---

**Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti Finance Kontabilitet disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në ciklin e parë (<b>RVB, Tab 18</b>). Nga vizita në institucion u informuar se këto statistika gjenden në regjistrin e të diplomuarve pranë sekretarisë mësimore dhe firmoset nga i diplomuari me marrjen e diplomës. (<b>Aneksi 7.4</b>).</p> <p>Sekretaria mesimore e fakultetit disponon statistika të plota për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë, për tërheqjet apo dhe largimet para përfundimit të programit mësimor. Të dhënat pasqyrohen në regjistrin e vlerësimit të studentëve. (<b>Ankesi 7.2</b>) Departamenti i Financë Kontabilitetit disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit nga pranimi, deri në diplomim.</p>
---	--

**Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Nga kryqëzimi i informacionit të marrë nga takimi me pedagogët dhe me studentë të zgjedhur në mënyrë të rastësishme rezultoi se për çdo grup mësimor studentësh, në fillim të vitit akademik, vendoset një pedagog këshillues nga Departamenti i Finance Kontabilitetit, për ndjekje të tyre nga afër gjatë gjithë vitit. Studentët që ndjekin aktualisht programin këshillohen sa herë që kanë nevojë për çështje të ndryshme, pasi e kanë të përcaktuar tutorin që ndjek ecurinë e tyre, si dhe kanë lidhje me zyrën e karrierës. <b>(Aneks 1.11).</b></p> <p>Pedagogu këshillues mbështet studentët si për procesin mësimor, vlerësimin, detyrimet e studentëve, kreditet që duhet të grumbullojnë për të kaluar nga një vit në tjetrin, edhe për aktivitete të tjera si: pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore, po kështu harmonizon veprimtaritë e tij këshilluese me atë të zyrës së këshillimit të karrierës së institucionit. Fakulteti Ekonomik ndjek në vazhdimësi progresin e studentëve dhe i ndihmon ata në procesin mësimor, por edhe në punën e tyre kërkimore. Kështu, gjatë vizitës në institucion u informuam se pedagogët dhe studentët kanë organizuar dy konferenca shkencore, kanë botuar një revistë studentore “Logos”, ku botojnë punimet e tyre të përbashkëta. (Anekset 5.12, 5.14, 7.13.1).</p> <p>Zyra e karrierës e Fakultetit Ekonomik ndihmon studentët për të përzgjedhur kompanitë/ institucionet në të cilat do zhvillojnë praktikën profesionale, sipas marrëveshjeve që kanë me këto kompani. <b>(Anekset 7.14, 8.1, 8.2).</b></p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

- ✓ KU Logos ndjek standarte të mirëpërcaktuara për pranimin në ciklin e parë të studimeve Bachelor në Financë Kontabilitet. Studentët që kërkojnë të ndjekin programin e studimit të ciklit të parë bachelor në Financë Kontabilitet, duhet të zotërojnë diplomën e maturës shtetërore, dhe të plotësojnë kriteret ligjore për pranimin në këtë universitet.
- ✓ Institucioni ka përgatitur e miratuar informacion të hollësishëm e mjaft kompleks për regjistrimin, ecurinë dhe karrierën e studentëve, duke mbajtur vazhdimisht e duke krijuar një bazë të mirë të dhënash përgjithëse për këta studentë.
- ✓ Studentët janë të mirëinformuar për procesin e akreditimit. Në të njëjtën kohë ata kanë marrë pjesë aktive në këtë process.
- ✓ Studentët ndiqen dhe konsultohen nga pedagogët si gjatë procesit mësimor dhe praktikës. Ndiqet progresi i studentëve në procesin mesimor, por edhe në punën e tyre kërkimore.

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor Pjesa përshkrimore

*Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Kërkimi shkencor është një komponent i rëndësishëm i programit të studimit. Politikat e kërkimit shkencor konsistojnë në: përzgjedhjen e tematikave dhe fushave të kërkimit shkencor në përputhje me nevojat e ekonomisë së vendit; në përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor; në nxitjen financiare që i bëhet stafit akademik për të mundësuar pjesëmarrje në konferenca e për botime në revista. Institucioni inkurajon e mbështet zhvillimin e punës kërkimore shkencore të pedagogëve të programit ciklit parë të studimeve bachelor Financë Kontabilitet. Zbatohen politika e procedura në plotësim të standarteve që kërkon hapësira europiane për arsimin e lartë. **(Aneksi 3.8)**

Kërkimi shkencor në këtë institucion është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, përfshirjes së teknologjive të reja në mësimdhënie por edhe nxit kualifikimin e stafit. Në këtë institucion, është ngritur një strukturë e vecantë për kërkimin shkencor me vendim të senatit nr 6/3, dt 08.09.2014. **(RVB fq 75)**. Puna kërkimore e KU "Logos" është e lidhur ngushtë edhe me marrëveshjet institucionale, shkëmbimin e eksperiencës me universitete të huaja. **(Aneksi 8.1)**.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

##### **Të dhëna për kërkimin shkencor**

Sipas **Tabeles 13 në aneks** shihet se KU "Logos" ka fituar **2 projekte** kërkimore, nga të cilat **1** është zbatuar, janë organizuar **18 aktivitete shkencore** nga IAL për programin e studimit, janë botuar **21 punime** shkencore nga stafi akademik efektiv i Fakultetit Ekonomik, **15 pjesëmarrës** kanë qenë pjesë e aktiviteteve shkencore brenda fakultetit, **23 studentë** kanë marrë pjesë në kërkimin shkencor.

Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni shtesë që morrëm, GVJ konkludoi që KU "Logos" ka alokuar fonde për kërkimin shkencor. Sipas të dhënave ky buxhet për vitin 2019 mbulon shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, organizim konferencash, trajnime, etj. Buxheti nuk është i specifikuar sipas Njësive kryesore dhe/apo Njësive bazë (përfshirë bën organizimi i konferencave), ndaj është e vështirë për të dhënë shifra të sakta për programin e studimit Financë-Kontabilitet. buxheti total për KU "Logos" është 3,550,000. Për vitet e tjera nuk është paraqitur buxheti total në dokument.

##### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Mbështetje financiare e institucionit për aktivitetin shkencor të stafit akademik.



## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.*

Nga dokumentacioni dhe vizitat në institucion rezultojnë se KU "Logos" ka lidhur marrëveshje me disa institucione të arsimit lartë brenda e jashtë vendit, në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Konkretisht janë ënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë", Universitetin e Pireut, Universitetin Sancti Cyrilli A.D. 1669 Malte, Universitetin e Maqedonisë Perëndimore të Greqisë, Universitetin Oradea Rumani. Këto marrëveshje synojnë zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit formimit teoriko profesional, të kërkimit shkencor. (Aneksi 8.1).

Nga informacionet e marra në institucion rezultojnë se bashkëpunimet me kompanitë e biznesit, bankat institucionet, janë përsëri në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Vlerësohen pjesëmarrjet e studentëve në leksione me specialistë nga kompanitë apo institucionet e mësipërme. (Aneksi 8.2).

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Sipas tabelës 14 në aneks, rezultojnë disa bashkëpunime kombëtare e ndërkombëtare të IAL Logos: kanë marrë pjesë **11 individë si partnerë në projekte** kombëtare apo ndërkombëtare, janë zhvilluar **9 leksione e seminare me lektorë të huaj** (ose orë mësimore), kanë marrë pjesë 7 vetë në kërkimin shkencor jashtë vendit, 15 studentë kanë qenë pjesë e mobilitetit nga dhe drejt programit të studimit, 8 kanë qenë pjesëmarrësit në aktivitete shkencore jashtë IAL/jashtë vendit me prezantime.

#### Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Sipas Tabelës 15 në aneks, kanë qenë të shumta institucionet qeveritare bashkëpunuese, 2 prej tyre, organizata profesionale 2 të tilla, nga komuniteti i biznesit 7 firma. Qëllimi i këtyre bashkëpunimeve ka qenë kryesisht për projekte të përbashkëta, për praktika profesionale të studentëve, por edhe për shkëmbim të eksperiencës.

#### Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Marrëveshje me universitete ndërkombëtare
- Marrëveshje UBT i rinovuar
- Programi Erasmus+, marrëveshje, thirrje, aktivitete
- Projekte

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>KU “Logos” në praktikën e punës së vet ka bashkëpunimin e stafit akademik për problemet lidhur me hartimin, zbatimin, mbikëqyrjen e planit dhe programit të studimit, me kërkimin shkencor, ndjekjen e mbikëqyrjen e praktikave profesionale, deri tek diplomimi i studentit. Nga informacionet në institucion rezultoi se ky bashkëpunim funksionon në dobi të përmiresimit të mësimdhënies.</p> <p>Brenda KU “Logos” janë krijuar kushtet e përshtatshme për bashkëpunim të mirë të stafit, për të mundësuar një lidhje organike të veprimtarisë mësimore, shkencore dhe edukative.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni për të realizuar programin e studimit ciklit parë Bachelor në Financë Kontabilitet, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit. <b>(Aneksi 8.1).</b></p> <p>Nga informacione të marra në institucion rezulton se KU “Logos” ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me biznese, kompani, institucione publike e private, me të cilat realizon praktikën mësimore të studentëve, leksione të hapura, për të përgatitur studentët me kulturën e punës dhe të tregut. <b>(Aneksi 8.2).</b></p> <p>Në fund të praktikës mësimore, pedagogu udhëheqës, por edhe mbikëqyrësi i praktikës në kompani, bëjnë vlerësimin e studentit, në përputhje me programin e praktikës profesionale për ciklin e parë të studimeve. <b>(Aneksi 7.7).</b></p> <p>KU “Logos” ka ngritur një strukturë të re “Bordi i tregut të punës”, për të bashkërenduar punën mes dy palëve, KU “Logos” dhe punëdhënësi, për të mbështetur e nxitur studentët për trajnime profesionale, për të qenë të përgatitur e konkurrues në tregun e punës pas diplomimit. <b>(Aneksi 1.15).</b></p> <p>Për praktikën profesionale të studentëve, institucioni mban evidencë të rregullt, me qëllim që të ndjekë në vazhdimësi jo vetëm ecurinë e studenteve për t'i</p>

vlerësuar për këtë element të programit mësimor, por edhe për ti ndjekur studentët në karrierën e tyre profesionale.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Mbështetur në vlerësimin e dhënë për secilin nga standardet GVJ konkludon:

- ✓ KU “Logos” për të realizuar programin e studimit ciklit parë Bachelor në Financë Kontabilitet, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit. Në këtë kontekst personeli akademik i KU Logos, publikon në revista shkencore, merr pjesë në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit.
- ✓ Përparësi ka rritja e nivelit shkencor të pedagogëve të rinj, stimulimi i specializimeve për ta, në universitete me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.
- ✓ Ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me biznese, kompani, institucione publike e private, me të cilat realizon praktikat mësimore të studentëve, leksione të hapura, për të përgatitur studentët me kulturën e punës dhe të tregut.

**ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Këshilli i Akreditimit në vendimin e tij Nr. 338, datë 08.06.2012 ka konstatuar që programi i studimit i përmbush objektivat formues, por ka edhe disa mangësi në realizimin tërësor dhe me cilësi të procesit të formimit të studentëve dhe pajisjes së tyre me dijet dhe shprehitë e nevojshme. Këshilli i Akreditimit ka dhënë disa rekomandime, për të cilat KU “Logos” ka punuar në vazhdimësi për plotësimin e tyre.

	<b>Rekomandimet nga akreditimi i parë</b>	<b>Statusi aktual</b>
a)	Të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe të krijohen strukturat përkatëse universitare si departamentet, etj.	<b>Përmbushur plotësisht</b> vetëm për periudhën 2014-2017
b)	Të punohet për hartimin e një metodologjie të shkruar për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit.	<b>Përmbushur plotësisht</b>
c)	Të punohet më shumë për përdorimin e metodave të tërthorta të vlerësimit për tërheqjen e organizuar të vlerësimit të programeve nga vet studentët	<b>Përmbushur plotësisht</b>
d)	Të rritet kapaciteti fizik i auditorëve dhe i shërbimeve ndihmëse	<b>Përmbushur plotësisht</b>
e)	Të plotësohen regjistrat	<b>Përmbushur plotësisht</b>
f)	Të punohet për rritjen e vizibilitetit të Institucionit në tregun përkatës, për të rritur mundësitë për tërheqjen e studentëve më cilësorë dhe për krijimin e mundësisë për rivendosjen e kritereve përzgjedhëse.	<b>Përmbushur kryesisht</b>

## II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

### a. Pika të forta:

- 1) Angazhimi në vazhdimësi për rritur numrin dhe cilësinë e stafit me kohë të plotë, duke rekrutuar staf të ri dhe të kualifikuar në universitete perëndimore;
- 2) Programi i studimit mbështetet në praktikat më të mira kombëtare;
- 3) Mbështetje financiare e vazhdueshme nga Fondacioni "Logos" për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të Kolegjit Universitar;
- 4) Mbështetja financiare, përmes bursave për disa kategori studentësh si: studentët nga familjet në nevojë, studentët me aftësi ndryshe dhe studentët me rezultate të shkëlqyera;
- 5) Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve mbështetëse.
- 6) Marrëveshjet me universitete brenda e jashtë vendit, por edhe me kompani biznesi e institucione të tjera, mundësojnë rritjen e nivelit të kërkimit shkencor, por dhe realizimin e praktikave profesionale.

### b. Pika të dobëta:

- 1) Mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu për këtë program studimi;
- 2) Mungesa e programeve specifike të trajnimit për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik;
- 3) Vështirësi në diversifikimin e burimeve të financimit si institucion jofitimprurës;

### c. Mundësitë:

- 1) Bashkëpunime të reja me universitete europiane do të mundësonin kualifikimin e stafit, si dhe mobilitetin e studenteve.
- 2) Bashkëpunimet me biznesin, institucione financiare, bankat, universitete të tjera brenda vendit, i shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale të studenteve, por ndikojnë dhe në punësimin e studenteve pas studimeve.
- 3) Pasurimi i bibliotekës online nga institucionet partnere, janë një mbështetje e mirë për pedagogët dhe për studentët.
- 4) Përfshirja e institucionit në projekte të financuara nga BE do të ndihmonte institucion për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
- 5) Burimet e garantuara të financimit mbështesin veprimtarinë afatmesme të KU "Logos".

### d. Pengesat:



- 1) Konkurrenca e madhe nga IAL të tjera që ofrojnë programe studimi të ngjashme bëhet pengesë për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar .
- 2) Ulja e numrit të maturantëve që vazhdojnë studimet e larta si rrjedhojë e ndryshimeve demografike ndikon në uljen e numrit të studentëve.
- 3) Mbyllja e programeve të doktoraturave për disa vite akademike vështirëson kualifikimin e kategorisë së asistent lektorëve.
- 4) Ulja e kërkesës së tregut të punës, kryesisht e sektorit bankar për specialistë finance, si rezultat i përdorimit të e-banking ndikon në nivelin e regjistrimeve.

### Rekomandime

GVJ mbështetur në të dhënat e analizuarra për çdo standard, konkluzionet e nxjerra dhe pikat e dobëta të identifikuarra, rekomandon që KU “Logos” duhet:

- 1) Të rishikojë strategjinë e tij për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi;
- 2) Të bëjë një studim tregu sipas kërkesave të Standardit II.1, Kriteri 2;
- 3) Të rishikojë politikat e rekrutimit për të garantuar që në përbërje të departamentit të ketë më shumë personel me grada dhe tituj akademikë;
- 4) Të pasurohet biblioteka me literaturë ndihmëse në funksion të programit të studimit;
- 5) Të barazohen gradualisht tarifat me kostot me qëllim që të rrit qëndrueshmërinë dhe zgjerohet aktivitetin mësimor dhe kërkimor;

## **II. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).**

### **a. Strengths**

- 1) Ongoing commitment to increase the number and quality of full time staff, by recruiting new staff and qualified on Western universities;
- 2) Study program builds on national best practices;
- 3) Ongoing financial support from the Logos Foundation for the teaching and research activity of the University College;
- 4) Financial support, through scholarships for some student categories such as: students from the families in needs, students with disabilities and excellent students;
- 5) The institution has the necessary and appropriate infrastructure for the development of the teaching process and support activities;
- 6) Agreements with national and international universities, but also with business companies and other institutions, enable the increase of the level of scientific research and the realization of professional practices.

### **b. Weaknesses**

- 1) Lack of a proper market study for this study program;

- 2) Lack of specific training programs for the continuous qualification of academic and non-academic staff;
- 3) Difficulties in diversifying funding sources as a non-profit institution;

**c. Opportunities**

- 1) New collaborations with European universities would enable staff qualification, as well as students' mobility;
- 2) Collaborations with businesses, financial institutions, banks, and other universities within the country serve to enhance the quality of teaching and research, enable students to pursue professional practices, but also affect student employment after graduation;
- 3) Enrichment of the online library by partner institutions, is a good support for academic staff and students;
- 4) Involvement of the institution in projects funded by EU will help the institution to increase the quality of teaching and scientific research;
- 5) Guaranteed funding sources support the mid-term activity of the University College "Logos";

**d. Threats**

- 1) The high competition from other HEIs offering similar study programs is an obstacle to increase the number of enrolled students;
- 2) The decrease of the number of high school graduates who continue their studies as a result of demographic changes affects the decrease in the number of students;
- 3) Closing the doctoral programs for several academic years makes it difficult the qualification of the assistant lecturers;
- 4) The decline of the labor market demand, mainly of the banking sector for finance specialists, as a result of the use of e-banking affects the level of registrations;

Recommendations:

The External Evaluation Team, based on the data analyzed for each standard, the conclusions drawn and the identified weaknesses, recommends that the University College "Logos" should:

- 1) Revise its strategy to increase the number of students enrolled in this study program;
- 2) Conduct a market study according to the requirements of Standard II.1, Criterion 2;
- 3) Review the recruitment policy to ensure that the department has more staff with academic degrees and titles;
- 4) To enrich the library with recommended literature for the purpose of the study program;
- 5) Gradually to equalize fees with costs in order to increase sustainability and expand teaching and research activity;

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr.Rajmonda DUKA**

**Prof.Dr.Ingrid SHULI**

## Lista e referencave

1. 00 Shkrese percjellese.pdf
2. 0.1 Mendimi i drejtuesit te njesise baze per programin BA Finance Kontabilitet.pdf
3. 0.2 Raport i vleresimit te brendshem periodik per programin BA Finance Kontabilitet.pdf
4. 0.3 Anekset.pdf
5. 1.1 VKM nr. 1055 dt. 29.07.2009 mbi licensimin eshlp logos.pdf
6. 1.2 Urdher 396 per lejimin e ushtrimit te vepramtarise se shlp logos.pdf
7. 1.3 Urdher MASH nr. 1, dt. 06.01.2011 mbi hapjen e programeve te reja prane shlp logos .pdf
8. 1.4 Urdher 481 MAS mbi lejimin e ushtrimit te veprimtarise se shlp logos.pdf
9. 1.5 Urdher MASH nr. 282 dt. 04.07.2012 mbi akreditimin institucional dhe te prog te studimit .pdf
10. 1.6 Rekomandimet e KA per akreditimin institucional dhe te prog te studimit (VKA Nr 338) Nr23.22 date 27.06.2012.pdf
11. 1.7 VS Nr 3 date 8.9.2014 i ndryshuar me VS Nr 14 date 5.5.2016 per krijimin e keshillit te fakultetit .pdf
12. 1.8 Vendim dekanati Nr 3 date 5.4.2016 per emerimin e koordinatorëve te prog te studimit.pdf
13. 1.9 VS Nr 11 date 7.11.2011 per funksionimin e NJSBC i ndryshuar me VS Nr 4 date 8.9.2014; i ndryshuar me VS Nr 12.3 date 16.11.2015; i ndryshuar me VS Nr 43 date 8.2.2018.pdf
14. 1.10 VS Nr 6.3 date 8.9.2014 per QKSH.pdf
15. 1.11 VS Nr 5.1 date 8.9.2014 per krijimin e zyres se keshillimit te karrieres.pdf
16. 1.12 VS Nr 7 date 27.10.2014 per miratimin e grupeve te punes per transferimin e studimeve.pdf
17. 1.12.1 Praktike transferimi.pdf
18. 1.13 VS Nr 6.1 date 8.9.2014 per krijimin e komisionit te rekrutimit te stafit akademik (praktike rekrutimi).pdf
19. 1.14 VS Nr 13 date 18.11.2011; i ndryshuar me VS Nr 5 date 8.9.2014 per krijimin e keshillit te etikës (kodi i etikës me VS Nr 13 date 13.1.2015 dhe relacioni i punes ne zbatim te kodit) .pdf
20. 1.15 VR-BTregu i Punes.pdf
21. 2.1 Akti i Themelimit te Fondacionit.pdf
22. 2.2 Kontrate Huaperdorje dhe Planimetrite 2008, 2015, 2016.pdf
23. 2.3+2.4 Vendim gjykate Nr 284 ndate 26.6.2008., vendim gjykate nr 284.1 date 22.6.2011pdf.pdf
24. 3.1.1 Statuti KU Logos 2011.pdf
25. 3.1.2 Statuti KU Logos 2017.pdf
26. 3.2.1 Rregullore e pergjithshme shlp Logos 2011.pdf
27. 3.2.2 Rregullore e pergjithshme KU LOGOS 2017.pdf
28. 3.3.1 Rregullore e Fakultetit Ekonomik 2012.pdf
29. 3.3.2 Rregullore e Fakultetit Ekonomik 2017.pdf
30. 3.4 Rregullore e Departamentit Finance Kontabilitet.pdf
31. 3.5.1 Rregullore e Prog te Studimit Bachelor 2012.pdf
32. 3.5.2 Rregullore e Prog te Studimit Bachelor 2017.pdf

33. 3.6 Plani Strategjik 2012-2017.pdf
34. 3.7 Strategjia e zhvillimit afatshkirter dhe afatmesem e departamentit FK 2017-2021.pdf
35. 3.8 Manual mbi Politikat dhe Procedurat e FE prane KU Logos, ne Zbatim te Misionit dhe Qellimit.pdf
36. 3.9 Plan zhvillimi FE per permiresimin e rezultateve te mesmdhencies dhe te te nxenit.pdf
37. 3.10 Plan Marketingu mbi Studimin e Tregut per Prog e Studimit MP ne F-K.pdf
38. 4.1 Plani mesimor, programet e lendeve per prog e studimit BA Finance Kontabilitet.pdf
39. 4.2 Plani i studimit per 2011 dhe ndryshimet per 2014.pdf
40. 4.3 Plani i studimit per 2014.pdf
41. 4.4 Draft Raporti per Vleresimin e Jashtem te prog te studimit BA Finance Kontabilitet.pdf
42. 4.5+4.6 Diploma dhe suplementi programi BA Finance Kontabilitet.pdf
43. 4.7 Raport mbi plotesimin e konkluzioneve finale te relacionit te MAS date 7.8.2014.pdf
44. 4.8 Relacion i MAS Nr 5860 date 7.8.2014 mbi monitorimin e shlp Logos.pdf
45. 4.9 VS Nr 3.4 date 28.8.2014 per pershtatjen e planit dhe te prog te studimit BA Finance Kontabilitet.pdf
46. 5.1 CV Beatrice Polo.pdf
47. 5.1 CV Blerina Banushi.pdf
48. 5.1 CV Elvis Xhori.pdf
49. 5.1 CV Iva Sulaj.pdf
50. 5.1 CV Jehona Germizi.pdf
51. 5.1 CV Klejda Gabeshi.pdf
52. 5.1 CV Soniela Kita.pdf
53. 5.2 VS per pedagoget e ftuar.pdf
54. 5.3 Praktike rekrutimi e stafit akademik.pdf
55. 5.4 Kontrate Pune e Stafit me kohe te Plote.pdf
56. 5.5 Kontrate Pune e Stafit me Kohe te Pjesshme.pdf
57. 5.6 VS pe rmiratimin e rregullores se QKSH Nr13.1 date 13.1.2015.pdf
58. 5.7 Rregullore e QKSH.pdf
59. 5.8 Programi i zhvillimit dh ekerkimit shkencor te shlp Logos 2014-2015.pdf
60. 5.9 Relacioni i punes kerkimore shkencore ne fakultetin enomik 2014-15.pdf
61. 5.10 Leksione te hapura me elspert vendas dhe te huaj.pdf
62. 5.11 Punimet shkencore te pedagoqeve, pasqyra per vitin 2017-18.pdf
63. 5.12 Revista Shkencore LOGOS Nr 1-Nr 5.pdf
64. 5.13.1 Projekt i fituar NECA.pdf
65. 5.13.2 Projekt i fituar IPA.pdf
66. 5.14 Konferencat Nderkombetare te organizuar nga Ku LOGOS.pdf
67. 6.1 Metodologji vleresimi.pdf
68. 6.2 Informacion i NJSBC mbi rezultatet e pyetesoreve per ciklinBA ne FK per vitin 2011-2012 (Tab permbledhese e vleresimeve te pedagoqeve, pyetesoret e vleresimit te studenteve per 2 pedagoqe) .pdf
69. 6.3 Info i NJSBC mbi rezultatet e pyetesoreve per BA Finance Kontabilitet per vitin 2014-2015)Vleresim semestral 2014-15, vleresim mbi punen vjetore te pedagoqeve nga pergjegjesi i departamentit.pdf
70. 6.4 Info i NJSBC mbi rezultatet e pyetesoreve 2015-16.pdf
71. 6.5 Informacion i NJSBC mbi rezultatet e pyetesoreve per BA Finance Kontabilitet per vitin 2017-18 (Raport i veprimtarise se NJSBC, pyetesoret e vleresimit per 2 pedagoqe).pdf






72. 7.1 Regjistri i te dhenave personale te studenteve 2012-15.pdf
73. 7.2 Regjistri i notave te studenteve.pdf
74. 7.3 Regjistri i grupit mesimor, model.pdf
75. 7.4 Regjistri i diplomave model.pdf
76. 7.5 Kontrate sherbimi per studentet.pdf
77. 7.6 Statistika per nr e studenteve ne vite.pdf
78. 7.7 Programi i praktikes profesionale dhe procedura e kryerjes se saj.pdf
79. 7.8 Vendim rektorati 2010 per miratimin e tarifave te studimit, 2 vendime rektorati dhe senati per rakordim bursash+listat e studenteve.pdf
80. 7.9+10+11 Rregullore e zyres se keshillimit te karrieres dhe VS Nr 13.1 date 13.1.2015 per miratimin e saj, Relacion dhe plan programin i ZKK te ku Logos, Alumni.pdf
81. 7.12 Leksionet e hapura me pedagogje te ftuar organizuara nga ZKK.pdf
82. 7.13.1 Konferencat studentore 1&2.pdf
83. 7.13.2 Revistat Studentore LOGOS Nr1&Nr2.pdf
84. 7.14 Kontrate me IMB, certifikata.pdf
85. 7.15 Guida e Studentit-2017.pdf
86. 7.16 Fletpalosja.pdf
87. 7.17 Analiza e punesimit te studenteve.pdf
88. 8.1 Marreveshje Universitetesh.pdf
89. 8.2 Marreveshje biznesi.pdf
90. 9.1+2+3+4 Pasqyrat financiare 2011-17,Raportet e audituesit 2015-17,te ardhurat totale sipas muajve 2012-16,vertetimi i bankes NBG date 7.2.2017 mbi garancine financiare.pdf
91. 10.1+2+3+4+5 Formulari teknik i plotesimit te normativave,planimetrit,deklarate per cilesine e materialit te ndertimit e cilesine akustike,Formulari i mbrojtjes ndaj zjarrit,leja higjeno-sanitare.pdf
92. Strategjia 2018-2024.pdf
93. Deklarata e rektorit KU Logos.pdf
94. Plani mesimor dhe syllabuset per programin e studimit BA Finance Kontabilitet, viti akademik 2018-19.pdf
95. Lista dhe ngarkesa ne ore e stafit akademik i departamentit dhe i programit te studimit Finance Kontabilitet, 2018-19.pdf
96. Marreveshje per percaktimin e numrit te personelit akademik me kohe te plote ne njesite baze\_MASR.pdf

#### **Dokumenta të marra gjatë vizitës në IAL**

1. 1. Ngarkesa totale e stafit akademik te programit BA Finance Kontabilitet.pdf
2. 2.1 Programi Erasmus+, Marreveshje, thirrje, aktivitete.pdf
3. 2.2 M.Sc Administrim Biznesi.pdf
4. 2.3 Marreveshje me universitete nderkombetare.pdf
5. 2.3 Marreveshje Universiteti Bujqesor i rinovuar.pdf
6. 2.4 Projekte.pdf
7. 2.5 Trajnime te stafit akademik per projekte nderkombetare.pdf
8. 2.6 Mbeshtetja financiare e institucionin per aktivitetin shkencor te stafit akademik+Praktike rimbursimi.pdf
9. 3.1 Formulare NJSBC 2019.pdf
10. 3.2 Politika per sigurimin e cilesise.pdf
11. 3.3 Rregullore per sigurimin e cilesise.pdf
12. 4. Rregullore e bibliotekes.pdf